



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# RAPORTI VJETOR 2022

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Tiranë, më 24.04.2023

*Miratuar me vendimin nr. 89, datë 24.04.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë*

## Fjala e Kryetarit

*E nderuar Zonja Kryetare!*

*Të nderuar deputetë të Kuvendit!*

Kanë kaluar tashmë pak më shumë se 4 vjet prej momentit të konstituimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pritshmëritë për të cilin kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të larta, në sytë e publikut, mediave, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve shtetërore dhe sot po paraqitet përpara Kuvendit raporti i veprimtarisë së këtij institucioni, për vitin 2022.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka mbartur përgjegjësinë e madhe, si një nga institucionet e reja të qeverisjes së drejtësisë, për të risjellë besimin e publikut tek drejtësia, duke garantuar zhvillimin e karrierës së prokurorëve vetëm mbi bazën e meritokracisë, duke patur në vëmendje, profesionalizmin, pavarësinë dhe integritetin e prokurorëve.

Sigurisht që, sfidat kanë qenë nga më të vështirat, duke patur në konsideratë që Këshilli i Lartë i Prokurorisë është institucion i ri: sfida të karakterit të brendshëm administrativ, pa harruar dhe rikonfigurimet që kanë ndodhur në përbërjen e Këshillit, sfida të karakterit ligjor, për të cilat Këshilli duhet të japë përgjigjet përkatëse, sfida të karakterit të jashtëm në raport me prokurorët në sistem, por edhe të karakterit ndërinstitutional, duke qenë se Këshilli i është dashur të ndërtojë ura të reja komunikimi dhe marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të rëndësishme si: Prokurori i Përgjithshëm, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Kuvendi, institucionet qendrore etj.

Sikurse përcakton Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në kuadër të garantimit të funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë dhe rivendosjes së besimit publik në institucionet e drejtësisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë është përpjekur që gjatë vitit 2022 të përmbushë detyrën e tij ligjore në mënyrë sa më eficiente dhe efikase të mundshme, duke mbuluar të gjithë ciklin e jetës profesionale të prokurorëve, nga pranimi në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës deri tek mbarimi i statusit, që konkludon të gjithë karrierën e prokurorit.

Viti 2022 është shënjuar nga procese si: ngritja në detyrë e drejtuesve të prokurorive pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, procedura e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele të prokurorëve, ngritja në detyrë e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, miratimi i disa akteve nënligjore të rëndësishme për karrierën e çdo prokurori, të cilat janë finalizuar me sukses dhe me standard të lartë, për atë çka kërkohet nga ana e këtij institucioni dhe në frymën e Reformës në Drejtësi.

Një arritje për Këshillin, ka qenë gjithashtu miratimi i Rregullores *“Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”*, si guri i parë i themelit për fillimin e procesit të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve, duke u bazuar në kriteret objektive, të përcaktuara në mënyrë të detajuar në këtë rregullore dhe anekset që e shoqërojnë atë.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm për vitin 2022, është bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë në dy drejtime: së pari në dhënien e kontributeve për ndryshime ligjore në fushën e drejtësisë, sa i përket përgjegjësisë që ligji i ka dhënë Këshillit, po ashtu edhe në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin prej procesit të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian.

Investimi që Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka arritur të realizojë gjatë këtyre viteve, duke përfshirë edhe vitin 2022, është sjellja e një qasjeje ndryshe tek *“Drejtësia e Re”*, me një imazh të pacenueshëm të sistemit, në respektim të parimeve themelore të shtetit të së drejtës.

Veprimtaria e Këshillit ka qenë e gjerë, gjithëpërfshirëse dhe nuk është e mundur të ceket në kaq pak fjalë. Prandaj, për të mësuar më tepër rreth veprimtarisë së Këshillit për vitin 2022, Ju ftoj të lexoni raportin vjetor.

**KRYETAR**  
**Alfred Balla**

## Lista e akronimeve

<b>KLP</b>	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
<b>KLJGJ</b>	Këshilli i Lartë Gjyqësor
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MEPJ</b>	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
<b>KPK</b>	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
<b>KPA</b>	Kolegji i Posaçëm i Apelit
<b>ILD</b>	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
<b>SHM</b>	Shkolla e Magjistraturës
<b>Ligji për Qeverisjen</b>	Ligj Nr. 115/2016 <i>“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar</i>
<b>Ligji për Statusin</b>	Ligj Nr. 96/2016 <i>“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar</i>
<b>Ligji për Prokurorinë</b>	Ligj Nr. 97/2016 <i>“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar</i>
<b>Ligji për Rivlerësimin</b>	Ligj Nr. 84/2016 <i>“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”</i>
<b>Komisioni i Karrierës</b>	Komisioni i Zhvillimit të Karrierës
<b>Komisioni i Vlerësimit</b>	Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional
<b>Komisioni i Buxhetit</b>	Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit
<b>Komisioni i Arkivimit</b>	Komisioni i Posaçëm për shqyrtimin e ankesave kundër arkivimit të hetimit nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
<b>SPAK</b>	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
<b>Gjykata e Posaçme</b>	Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

## Tabela e përmbajtjes

<b>Fjala e Kryetarit .....</b>	<b>2</b>
<b>A. Përmbledhje e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë gjatë vitit 2022</b>	<b>6</b>
<b>B. Gjendja e burimeve njerëzore dhe projeksiioni për tri vitet e ardhshme të sistemit të prokurorisë.....</b>	<b>6</b>
1. Gjendja e organikave të zyrave të prokurorisë në raport me vakancat faktike.....	6
2. Të dhëna mbi procesin e rivlerësimit kalimtar të Prokurorëve .....	9
3. Projeksiioni i gjendjes së sistemit të Prokurorisë, në lidhje me vakancat, për vitin 2023 .....	11
<b>C. Marrëdhëniet ndërinstitucionale të Këshillit të Lartë të Prokurorisë .....</b>	<b>11</b>
4. Marrëdhëniet me Shkollën e Magjistraturës .....	11
5. Marrëdhëniet me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.....	13
6. Marrëdhëniet me Prokurorinë e Përgjithshme.....	14
7. Marrëdhëniet me institucionet e rivlerësimit kalimtar .....	15
8. Marrëdhëniet me Kuvendin.....	15
<b>D. Transparenca ndaj publikut dhe mediave.....</b>	<b>15</b>
<b>E. Propozime për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe adresimin e problematikave të sistemit .....</b>	<b>17</b>
9. Programi i Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës me kohëzgjatje 3 vjet të bëhet në 2 vjet, për një periudhë tranzitore.....	17
10. Rregullimi i procedurës së procedimit disiplinor.....	19
11. Shfuqizimi i parashikimit ligjor për kryerjen e verifikimit të pasurisë dhe figurës për të diplomuarit në Shkollën e Magjistraturës .....	20
12. Shtimi i funksionit të këshilltarit ligjor në prokuroritë e shkallëve të para dhe të apelit të juridiksion të përgjithshëm.....	21
<b>F. Veprimtaria financiare dhe administrative.....</b>	<b>22</b>
13. Struktura dhe organigrama e KLP-së.....	22
14. Procesi i rekrutimit të nëpunësve civilë.....	22
15. Buxheti i negociuar dhe alokuar për vitin 2022 .....	23
16. Nevojat buxhetore.....	24
17. Proceset gjyqësore.....	25
<b>G. Veprimtaria e komisioneve të përhershme dhe komisioneve të tjera të Këshillit. ....</b>	<b>28</b>
Komisionet e Përhershme.....	28
18. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit .....	28
a. Miratimin e kërkesave buxhetore për vitin 2023-2025 .....	28

b.	Miratimin e kërkesave për lejimin e veprimtarive jashtë funksionit për prokurorët .	29
19.	Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale .....	29
a.	Raporte të vlerësimit të aftësive profesionale të prokurorëve .....	34
b.	Verifikimi i pasurisë dhe figurës për kandidatët për pozicion drejtuesi në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm .....	36
20.	Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.....	37
21.	Komisioni i Disiplinor.....	40
a.	Procedime disiplinore ndaj prokurorëve.....	40
b.	Procedura disiplinore në proces.....	41
c.	Hetime disiplinore të filluara nga ILD .....	42
d.	Hartimi dhe miratimi i akteve, relacioneve, projekt-vendimeve të Komisionit Disiplinor dhe këshillit .....	42
e.	Regjistri disiplinor.....	42
	Komisionet e tjera .....	43
22.	Veprimtaria e Komisionit për mbrojtjen e prokurorëve .....	43
23.	Komisioni i Posaçëm për shqyrtimin e ankesave kundër arkivimit të hetimit nga ana e ILD-së.....	45
<b>H.</b>	<b>Rezoluta e fundit e Kuvendit, zbatimi dhe sfidat e KLP për vitin 2023 .....</b>	<b>45</b>
24.	Niveli i zbatimit të rezolutës së Kuvendit “Për raportin vjetor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2020” .....	45
25.	Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2022 i rekomandon KLP-së: .....	46
26.	Konkluzione të nxjerra nga veprimtaria e vitit 2022 dhe sfidat për vitin 2023 .....	50

## **A. Përmbledhje e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë gjatë vitit 2022**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë gjatë vitit 2022, ka marrë gjithsej 333 vendime, në 35 mbledhje plenare të zhvilluara. Vendimmarrja ka qenë kryesisht e lidhur me akte administrative individuale në funksion të karrierës së prokurorëve. KLP-ja ka pasur gjithashtu në vëmendje dhe ka punuar intensivisht për hartimin dhe miratimin e disa akteve nënligjore, si: Rregullorja për komunikimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me median , Rregullorja për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm , Rregullorja për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve , Standardet e etikës dhe sjelljes së prokurorëve , Rregullorja për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë etj.

Sipas parashikimeve të Nenit 167 dhe 178 të Ligjit për Qeverisjen, pranë KLP-së funksionon Sektori i Dokumentimit të Seancave, i cili përgatit dosjet me aktet përkatëse për mbledhjet plenare sipas rendit të ditës, zbardh procesverbalet e mbledhjeve, pasqyron mendimet e anëtarëve të Këshillit, propozimet apo vërejtjet që ata kanë lidhur me diskutimet e tyre gjatë mbledhjes, duke i bërë ato pjesë të procesverbalit, redakton materialet e mbledhjeve në respektim të të drejtave të privatësisë, konfidencialitetit, të dhënave personale apo sensitive në raport me palët e treta, etj.

Mbledhjet plenare të KLP-së janë ndjekur nga përfaqësues të institucioneve dhe organizatave të akredituara pranë KLP-së, si dhe nga programet e asistencës ndërkombëtare për zbatimin e Reformës në Drejtësi, EURALIUS deri në Shkurt 2022 dhe OPDAT.

Për mbledhjet plenare të zhvilluar me prezencë fizike të anëtarëve, në kushtet e kufizimit të numrit të pjesëmarrësve të pranishëm fizikisht, çdo i interesuar, duke përfshirë median, shoqërinë civile apo çdo entitet tjetër të interesuar për veprimtarinë e KLP-së, u është kërkuar të paraqesin një kërkesë me shkrim, në adresën [info@klp.al](mailto:info@klp.al) për akreditim, në mënyrë që të sigurojnë qasje në linkun e mbledhjes plenare, për ta ndjekur live.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vijuar punën me përgjegjshmëri dhe angazhim maksimal në përmbushjen e detyrimeve të tij kushtetuese dhe ligjore, duke zbatuar të gjitha procedurat e nevojshme për realizimin e mbledhjeve plenare, si njoftimi i rendit të ditës së mbledhjes plenare 24 orë para zhvillimit të tyre dhe publikimi me transparencë i të gjitha mbledhjeve plenare dhe vendimeve të marra në to, në faqen zyrtare të Këshillit [www.klp.al](http://www.klp.al), përfshirë këtu dhe regjistrimin audio të mbledhjes.

## **B. Gjendja e burimeve njerëzore dhe projekcioni për tri vitet e ardhshme të sistemit të prokurorisë**

### **1. Gjendja e organikave të zyrave të prokurorisë në raport me vakancat faktike**

Krijimi i vakancave si pasojë e vijimit të procesit të Vetting-ut ka sjellë ndryshime të qenësishme në gjendjen aktuale të sistemit të prokurorisë. Njëkohësisht, përveç sistemit të rivlerësimit kalimtar, i cili është duke lënë gjurmë të dukshme në zyrat e prokurorive, gjatë vitit 2022 ka pasur edhe kërkesa për dorëheqje, largime të prokurorëve që mbushin moshën e pensionit etj., të cilët kanë ndikuar gjithashtu në uljen e numrit të prokurorëve në sistem. Për rrjedhojë, ulja e numrit të prokurorëve ka shkaktuar një mbingarkesë të tyre, gjë që nuk reflekton punën e tyre në një situatë normale.

Më poshtë, do të paraqesim në mënyrë analitike situatën faktike të prokurorive, organikën e miratuar dhe ndarjet përkatëse sipas shkallëve, vakancat e krijuara, të përhershme dhe të përkohshme, prokurorët e komanduar dhe prokurorë të tjerë që nuk e ushtrojnë funksionin për shkaqe të tjera, rastet e mbarimit të funksionit për shkak të dorëheqjes, daljes në pension, apo largimit nga jeta etj.

Në Shqipëri deri në fund të vitit 2022 kanë ushtruar funksionin:

- a. 22 zyra prokurorie pranë Gjykatave të Shkallëve të Para;
- b. 6 zyra prokurorie pranë Gjykatave të Apelit;
- c. Prokuroria e Posaçme SPAK;
- d. Prokuroria e Përgjithshme.

Organika totale e miratuar për gjithë sistemin e prokurorive është 341 prokurorë nga të cilët:

- a. 278 për Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë;
- b. 26 për Prokuroritë pranë Gjykatave të Apelit;
- c. 20 për SPAK;
- d. 17 për Prokurorinë e Përgjithshme.

Organika aktuale me prokurorë të emëruar për çdo shkallë është:

<b>Shkalla e parë:</b>	<b>241 të emëruar</b>	<b>37 vakanca të përherëshme</b>
<b>Apelet:</b>	16 të emëruar	10 vakanca të përherëshme
<b>SPAK:</b>	17 të emëruar	3 vakanca të përherëshme
<b>Prokuroria e Përgjithshme:</b>	14 të emëruar	3 vakanca të përherëshme
<b>TOTALI:</b>	288 të emëruar	53 vakanca të përherëshme

Numri faktik i prokurorëve që ushtronin detyrën deri në dhjetor 2022 ishte 214 prokurorë.

Sa i përket prokurorëve të komanduar dhe prokurorëve që i përkasin rasteve të tjerë të parashikuar me ligj, që nuk kryejnë detyrën aktualisht si prokurorë, numri i tyre është 20 prokurorë dhe përkatësisht janë ndarë si më poshtë:

- a. 6 Anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- b. 5 të komanduar në Këshillit të Lartë të Prokurorisë si këshilltarë;
- c. 1 në Këshillin e Lartë të Prokurorisë si Këshilltar Etike;
- d. 4 në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë;
- e. 1 në Ministrinë e Drejtësisë;
- f. 1 në EUROJUST;
- g. 2 në Prokurorinë e Përgjithshme

Më poshtë është paraqitur në formë tabelore gjendja për organikën:

Shkalla Parë	Organika	Vakancë e përkohshme	Vakancë e përhershme	Vakancë total	Në detyrë
Berat	7	2	0	2	6
Dibër	6	2	0	2	5
Durrës	27	6	2	8	19
Elbasan	25	5	6	11	14
Fier	14	5	1	6	8
Gjirokastrë	7	2	1	3	4
Kavajë	7	0	4	4	3
Korçë	13	3	1	4	9
Krujë	7	1	1	2	5
Kukës	5	2	1	3	4
Kurbin	4	0	1	1	3
Lezhë	10	3	0	3	7
Lushnje	7	3	1	4	4
Mat	3	0	1	1	2
Përmet	2	1	0	1	1
Pogradec	4	1	1	2	2
Pukë	2	1	0	1	1
Sarandë	7	2	1	3	5
Shkodër	19	5	3	8	11
Tiranë	80	26	13	39	41
Tropojë	3	1	0	1	2
Vlorë	19	6	0	6	13
	278	77	38	115	169

Prokuroritë e Apeleve	Organika	Në detyrë	Vakancë e përkohshme	Vakancë e përhershme	Vakancë total
Durrës	4	3	0	2	2
Gjirokastrë	2	1	0	1	1
Korçë	2	2	1	0	1
Vlorë	5	2	3	1	4
Shkodër	4	2	0	3	3
Tiranë	9	5	2	3	5
Total Apelet	26	15	6	10	16



	Organika	Në detyrë	Vakancë e përkohshme	Vakancë e përhershme	Vakancë total
<b>SPAK</b>	20	17	0	3	3
<b>Prokuror i Përgjithshëm</b>	17	13	3	3	6

<b>Nr. total sipas Organikës</b>	341	100%
<b>Në detyrë si prokuror</b>	214	62.76
<b>Të komanduar jashtë sistemit dhe Anëtarë të KLP</b>	20	5.87
<b>Vakanca pa komandimet dhe KLP</b>	107	31.38
<b>Vakanca total</b>	127	37.24

Me zbatimin e hartës së re gjyqësore, përkatësisht për prokuroritë në nivel apeli më datë 01.02.2023 dhe prokuroritë në shkallët e para më datë 01.05.2023, organika faktike si dhe ngarkesa mesatare për prokuror pritet të përmirësohet ndjeshëm.

## 2. Të dhëna mbi procesin e rivlerësimit kalimtar të Prokurorëve

- Numri i prokurorëve që i janë nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting) është:
  - a. 91 - Të konfirmuar me vendim të formës së prerë.
  - b. 9 - Të konfirmuar në KPK dhe të ankimuar në KPA
  - c. 7 - Në pritje për konfirmim apo ankimim
  - d. 54 – Shkarkuar nga KPK
  - e. 50 - Të shkarkuar nga KPA
- Numri i prokurorëve të shkarkuar me vendim përfundimtar.

Prokuroria	Numri
<b>Nga Shkalla e parë</b>	33
<b>Krimet e Rënda</b>	2
<b>Apel</b>	10
<b>Prokurori e Përgjithshme</b>	5
<b>Total</b>	50

- Numri i prokurorëve të cilët duhet t'i nënshtrohen ende Vetting-ut është 87 pasi:

Total të emëruar janë: 288 dhe nga këta: 107 janë të konfirmuar, të ankimuar dhe në pritje, 54 janë të pezulluar dhe 40 janë të emëruar.

- Numri i prokurorëve të cilët kanë dhënë dorëheqjen nga pozicioni pas miratimit të paketës së ligjeve të Reformës në Drejtësi:

**Total**                    **21**

- Numri i prokurorëve të cilët janë larguar nga sistemi për shkak pensioni pas miratimit të paketës së ligjeve të Reformës në Drejtësi:

**Total 11**

- Numri i prokurorëve të cilët janë larguar nga sistemi për arsye të tjera pas miratimit të paketës së ligjeve të Reformës në Drejtësi:

**Total 3**

1 i zgjedhur anëtar në Gjykatën Kushtetuese

2 për shkak ndarjes nga jeta

Sikurse vihet re edhe këtë vit vakancat e krijuara kryesisht nga procesi i rivlerësimit kalimtar mbeten të konsiderueshme, duke sjellë problematika në lidhje me mbingarkesën e prokurorëve dhe për rrjedhojë mbartjen e dosjeve në vitin pasardhës, fakt i cili pasqyrohet edhe nga raportimi e Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me ngarkesa e punës për çdo prokurori si dhe numri i dosjeve të mbartura për këtë vit.

<i>Prokuroria</i>	<b>Ngarkesa mesatare faktike</b>	<b>Ngarkesa mesatare efektive</b>
<i>Lushnje</i>	470	537
<i>Berat</i>	467	
<i>Sarandë</i>	440	489
<i>Tiranë</i>	414	426
<i>Kavajë</i>	381	381
<i>Pogradec</i>	361	433
<i>Shkodër</i>	356	435
<i>Dibër</i>	355	418
<i>Durrës</i>	318	341
<i>Vlorë</i>	301	326
<i>Fier</i>	300	250
<i>Krujë</i>	296	296
<i>Kukës</i>	288	432
<i>Gjirokastrë</i>	286	343
<i>Përmet</i>	278	278
<i>Lezhë</i>	273	294
<i>Tropojë</i>	262	349
<i>Korçë</i>	261	360
<i>Kurbín</i>	238	286
<i>Elbasan</i>	235	243
<i>Pukë</i>	174	174
<i>Mat</i>	174	174

Konstatohet se gjatë vitit 2022 janë mbartur 21865 procedime penale, ku sipas vlerësimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka ardhur si pasojë e mungesave të shumta në organikat e zyrave të prokurorive.

Gjithashtu vihet re vështirësi në respektimin e afateve procedurale që pasqyrohet edhe në rastet e fillimit të hetimit disiplinor nga ILD për këtë shkak.

Kjo problematikë pritet të lehtësohet në vitin në vijim me implementimin e hartës së re gjyqësore, e cila parashikohet të sjellë një ndarje më të drejtë dhe të barabartë të ngarkesës për secilin prokuror, me miratimin e mundshëm të ndryshimeve ligjore të propozuara nga KLP, si dhe me emërimet e magistratëve të rinj që përfundojnë programin e trajnimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

### **3. Projektioni i gjendjes së sistemit të Prokurorisë, në lidhje me vakancat, për vitin 2023**

Në kuadër të menaxhimit të sistemit të prokurorisë sa i takon burimeve njerëzore, është bërë një projektion mbi vakancat për vitet në vijim. Aktualisht ndjekin studimet 75 studentë nga të cilët 26 emërohen gjatë vitit 2023. Në vitin akademik 2023-2024 Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kërkuar 40 studentë të profilit prokuror.

Numri i vakancave në sistemin e prokurorisë është 56 vakanca të përhershme dhe 85 vakanca të përkohshme, deri në këtë moment. ***Ndërkohë numri total i organikës së prokurorëve është 341.*** Numri i prokurorëve që mbushin moshën e pensionit për tre vitet e ardhshme është 3 prokurorë.

Nga një analizë e mesatares së largimeve në përqindje, rezulton se nga fillimi i procesit deri sot janë larguar 54.7% e prokurorëve që i'u janë nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar. Deri më datë 06.04.2023 janë edhe 80 prokurorë në detyrë që nuk kanë përfunduar ende rivlerësimin kalimtar. Në vijim të këtij trendi statistikor në një pikëpamje matematikore pritet që në përfundim të këtij procesi pranë Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit të krijohen edhe 44 vakanca të përkohshme.

Duke pasur në konsideratë që në masën 93% vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit mbeten në fuqi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, arrihet në një përfundim logjik (bazuar në probabilitetin matematikor) që në sistemin e prokurorisë mund të shtohen vakancat e përhershme me 56 vende, duke akumuluar një numër maksimal prej 106 vakancash të përhershme. Këtu duhet mbajtur parasysh fakti se është e vështirë të parashikohet faktori i largimeve për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, çka bën që ky numër mos të jetë plotësisht i saktë.

Në përfundim prej numrit maksimal prej 106 vakancave potenciale duhet të zbresim numrin e studentëve që emërohen gjatë vitit 2023 (26 kandidatë) dhe përfitojmë projektionin e nevojave për vitin 2023, që është i barabartë me 80 vakanca të përhershme. Duke ndjekur të njëjtën logjikë arsyetimi parashikohet se brenda 3 viteve të ardhshme, me përfundimin edhe të procesit të Vetting-out, vakancat në sistemin e prokurorisë të eliminohen thuajse plotësisht.

### **C. Marrëdhëniet ndërinstitucionale të Këshillit të Lartë të Prokurorisë**

#### **4. Marrëdhëniet me Shkollën e Magjistraturës**

Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës ka vijuar të jetë intensiv gjatë vitit 2022. KLP-ja ka përmbytur detyrimet e saj ligjore, në komunikim të vazhdueshëm me Shkollën e Magjistraturës, për emërimin dhe caktimin në detyrë të prokurorëve të rinj, verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve që aplikojnë për t'u pranuar në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2022-2023, miratimi i kalendarëve të trajnimeve vazhdues të prokurorëve etj.

Caktimi në detyrë dhe emërimi i magistratëve të rinj, profili prokuror, që kanë përfunduar Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magistraturës është një detyrë që ligji ia ka ngarkuar KLP-së. Prej momentit të konstituimit të KLP-së, janë caktuar në detyrë dhe emëruar 40 prokurorë të rinj. Gjatë vitit 2022, pas përfundimit të procesit të vlerësimit etiko-profesional, me vendimet Nr.165-187, datë 12.07.2022, të KLP-së, janë emëruar 22 prokurorë. Me vendimin Nr.187, datë 12.07.2022, janë shpallur 22 vende të lira për prokurorët e emëruar në vitin 2022 dhe me vendimet Nr.200-221, datë 27.07.2022, janë caktuar në detyrën e prokurorit, të 22 prokurorët e rinj, të cilët janë caktuar në prokurori të ndryshme si: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, Kukës, Dibër, Tropojë, Shkodër, Lezhë, Lushnje, Vlorë, Korçë, Berat, Sarandë, Pogradec, Gjirokastrë.

Duke pasur në konsideratë Ligjin për Statusin, KLP-ja ka detyrimin ligjor të përcaktojë numrin maksimal të kandidatëve magistratë të profilit prokuror që pranohen në Programin e Formimit Fillestar.

Konkretisht në pikën 1, të nenit 29, të këtij Ligji përcakton se : *“Në janar të çdo viti, Këshillat, pasi kanë kryer një analizë të nevojave, përcaktojnë dhe publikojnë numrin maksimal të kandidatëve magistratë që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik”.*

Gjithashtu referuar Ligjit për Qeverisjen, pika 1, e nenit 183 përcakton se: *“Këshilli Lartë i Prokurorisë bashkëpunon me Shkollën e Magistraturës për rekrutimin e kandidatëve për prokurorë, në pajtim me këtë ligj dhe ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe emëron prokurorët pas diplomimit në Shkollën e Magistraturës”.*

Nga sa më sipër, KLP-ja pas një analize të nevojave të sistemit dhe faktorëve që ndikojnë në përcaktimin e numrit maksimal të kandidatëve, si: vendet vakante të përhershme aktualisht në sistem; numri i studentëve që ndjekin aktualisht Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magistraturës, kapacitetet e Shkollës së Magistraturës, prokurorët që mbushin moshën e pensionit në 3 vitet e fundit si dhe, përcaktimi i një trendi të largimeve nga sistemi të prokurorëve në funksion nga organet e rivlerësimit kalimtar, përcaktoi numrin maksimal të kandidatëve magistratë të profilit prokuror që do të pranohen për vitin akademik 2022-2023 prej 35 kandidatësh magistratë të profilit prokuror.

Me vendimin Nr.58, datë 31.03.2022, KLP-ja, pas përcjelljes së listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore, për t'u pranuar në Programin e Formimit Fillestar, ka miratuar komentet dhe kundërshtimet të raportit të vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magistraturës për vitin akademik 2022 - 2023 për profilin "prokuror".

Me Vendimin Nr.138, datë 02.06.2022, "Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për t'u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magistraturës në vitin akademik 2022-2023" ka filluar verifikimin për 29 kandidatë.

Me Vendimet mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për t'u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magistraturës në vitin akademik 2022-2023, KLP-ja ka përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës për 27 (njëzet e shtatë) kandidatë. Nga 29 (njëzet e nëntë) kandidatë gjithsej, për 2 (dy) kandidatë nuk ka përfunduar ende procedura e verifikimit, 1 (një) kandidat është ndaluar për t'u pranuar në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magistraturës dhe 1 (një) kandidat është tërhequr nga kandidimi. Pra, për 26 kandidatët e tjerë ka përfunduar procedura e verifikimit me pranimin e tyre në Programin e SHM.

## 5. Marrëdhëniet me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme

Këshilli i Ministrave, me vendimin Nr.823, datë 24.12.2021 ka miratuar Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë, Planin e saj të Veprimit dhe Pasaportën e Indikatorëve, për periudhën 2021-2025, për të cilin, Ministria e Drejtësisë është institucion koordinues.

Për këtë dokument të rëndësishëm strategjik, KLP-ja ka përgatitur kontributin për periudhën Janar-Qershor 2022, si dhe kontributin vjetor Janar-Dhjetor 2022 në kuadër të kësaj strategjie, Planit të saj të Veprimit, si dhe Pasaportës së Indikatorëve.

Përveç Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, e cila konsiderohet si strategjia ombrellë e të gjitha strategjive të tjera në fushën e drejtësisë, vlen për t'u përmendur se, KLP-ja ka dhënë kontribut edhe për:

- a. Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur, Planit të saj të Veprimit, si dhe Pasaportës së Indikatorëve, për të cilën ka dhënë sugjerime përpara miratimit të saj në muajin dhjetor 2022, si dhe pritet të kryejë raportin vjetor në fillim të vitit 2023;
- b. Strategjinë kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, për Planin e saj të Veprimit.

Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë ka vijuar edhe për Planin Kombëtar për Integrimin Evropian. KLP-ja nga ana e tij, ka raportuar gjerësisht më datë 30.11.2022, për PKIE 2023-2025. Ky raportim ka mbuluar veprimtarinë e këshillit për vitin 2022.

Gjithashtu, KLP-ja ka bashkëpunuar ngushtësisht me Ministrinë e Drejtësisë dhe me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, lidhur me përmbushjen e treguesit Nr.1, në zbatim të Kontratës Sektoriale “BE për Reformën në Drejtësi”, miratuar me VKM nr. 476, datë 10.07.2019 mbi “Miratimin në parim të Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian”, dhe ka marrë pjesë në takimet dhe seminarët e zhvilluara nga ana e tyre, në kuadër të përmbushjes së indikatorëve të kësaj kontrate. Është kërkuar njëkohësisht në mënyrë të vazhdueshme, nga ana e KLP-së, rishikimi i indikatorit që prek veprimtarinë e KLP-së, duke dhënë edhe shpjegimet përkatëse, por ky indikator nuk pësoi ndryshime. Raportimi për kontratën “BE për Reformën në Drejtësi” pritet të kryhet në fillim të vitit 2023.

Duke qenë se fokusi aktual, në funksion të bashkëpunimit ndërinstitucional, është integrimi evropian, KLP-ja ka raportuar për Ministrinë e Drejtësisë edhe për monitorimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian, Komitetit të Stabilizim Asociimit dhe Nënkomitetit për Kapitullin 23.

Përveç sa më sipër, KLP-ja ka dhënë kontribute edhe për dokumente të tjerë të rëndësishëm dhe për aktivitete që lidhen me procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

KLP-ja, në cilësinë e anëtarit të Grupit të Punës për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, ka raportuar për hartimin dhe dërgimin e kontributit të dytë të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022, që mbulon periudhën 01.03.2022-15.06.2022. Periudha 01.01.2022 deri më 28.02.2022, është përcjellë në një raportim të mëparshëm, që mbulon 01.06.2021-28.02.2022.

Po në kuadër të procesit të negociatave, KLP-ja ka marrë pjesë më datë 15.02.2022, në takimin e njëmbëdhjetë të Komitetit të Stabilizim Asociimit. Gjatë këtij takimi, sa i përket Reformës në Drejtësi dhe punës së institucioneve të qeverisjes së drejtësisë, nga ana e

Komisionit Evropian, u vlerësua progresi i madh nga ana e këtyre institucioneve. Nga ana e KLP-së është paraqitur raportimi i përditësuar deri në muajin shkurt 2022 për këtë takim, sipas axhendës së dërguar nga ana e Komitetit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian – Shqipëri.

Gjithashtu, në datat 26-27 shtator 2022, KLP-ja mori pjesë në takimin shpjegues për Kapitullin 23 *“Gjyqësori dhe të drejtat themelore”* në Bruksel, mbi zhvillimet e acquis që prej shtatorit të vitit 2018 e në vijim. KLP-ja u përfaqësua në këtë takim nga Kryetari, zoti Alfred Balla.

Në vijim të këtij takimi, në datat 24-25 Nëntor 2022, u zhvillua takimi i dytë në Bruksel, i cili kishte për qëllim raportimin përpara zyrtarëve të lartë të Komisionit Evropian, mbi arritjet e deritanishme të sistemit gjyqësor e prokurorial. KLP-ja u përfaqësua në këtë takim nga Kryetari, zoti Alfred Balla dhe zonja Eloida Goxhi, anëtare e KLP-së.

KLP-ja, së bashku me institucionet e tjera të drejtësisë, përgatitën një prezantim të veprimtarisë së tyre prej momentit të hyrjes në fuqi të paketës së ligjeve të Reformës në Drejtësi e deri aktualisht.

## **6. Marrëdhëniet me Prokurorinë e Përgjithshme**

Më datë 25.10.2022, Prokurori i Përgjithshëm thirri Mbledhjen e Përgjithshme të Prokurorëve, prej së cilës do të zgjidhej anëtari i ri i KLP-së, nga radhët e prokurorëve të prokurorisë pranë gjykatave të apelit. 200 prokurorë të të gjitha niveleve morën pjesë në mbledhje dhe votuan midis dy kandidatëve që kishin shprehur interesin për të kandiduar si anëtar i KLP-së. Në përfundim të votimit u shpall fituese zonja Ledina Riza.

Zonja Ledina Riza u zgjodh anëtare e KLP-së, nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve, si përfaqësuese e Prokurorisë së Apelit Tiranë, dhe me vendimin Nr.301, datë 10.11.2022, ajo mori edhe funksionet e anëtares së Komisionit të Vlerësimit.

Së dyti, bazuar në pikën 2, të nenit 105, të Ligjit për Prokurorinë ku përcaktohet se, *“Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme raportojnë, të paktën një herë në vit, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë lidhur me ecurinë e veprimtarisë së strukturave përkatëse”*, më datë 16.05.2022, pranë KLP-së ka raportuar Prokurori i Përgjithshëm, lidhur me veprimtarinë e sistemit të prokurorisë gjatë vitit 2021.

Zoti Olsian Çela paraqiti në mënyrë të përmbledhur raportin mbi veprimtarinë e sistemit të prokurorisë gjatë vitit 2021, duke analizuar e punën e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm, atë të prokurorisë pranë gjykatave të apelit në përfundim dhe të vetë institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme.

Një vëmendje e veçantë gjatë relatimit iu kushtua çështjeve si: rritja e rezultateve në një sërë objektivash të fokusit të veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme, nëpërmjet masave administrative dhe procedurale institucionale me miratimet e udhëzimeve të përgjithshme dhe planeve të veprimit për të unifikuar veprimtarinë e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre; aspekteve të veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2021, mbi organizimin e brendshëm, gjendjen, progresin, problematikat dhe mbështetjen që synohet; miratimin e dy rregulloreve standard, për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe prokurorisë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, si dhe një sërë udhëzimesh të tjera të përgjithshme etj.

## **7. Marrëdhëniet me institucionet e rivlerësimit kalimtar**

Komisioni i Vlerësimit, bazuar në nenin 160, pika 2, germa “d”, të Ligjit për Statusin, siç parashikohet në dispozitën kalimtare të këtij ligji, asiston Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (më tej, KPK) dhe përgatit raportet e vlerësimit të aftësive profesionale në kuadër të procesit të rivlerësimit.

Në funksion të këtij procesi, Komisioni është ndihmuar nga 5 (pesë) prokurorë të sistemit të prokurorisë, të cilët janë komanduar pranë KLP-së, për një periudhë tre-vjeçare me vendimet Nr. 66-71, datë 24.02.2020, të KLP-së.

Këto raporte janë hartuar duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara në bashkëpunim me KPK-në si, aftësitë profesionale, aftësitë organizative, etika dhe angazhimi në veprimtari profesionale, dhe duke u bazuar në gjetjet në aktet e administruara, për analizimin e aftësive profesionale.

Gjatë vitit 2022, janë përgatitur dhe janë miratuar në seancë plenare nga KLP-ja, gjithsej 32 (tridhjetë e dy) raporte për subjekte magjistratë (prokurorë), që janë vënë në dispozicion të KPK-së dhe ONM-së.

Gjithashtu, gjatë periudhës së raportimit, pranë KLP-së janë administruar një sërë kërkesash të KPK-së sa i takon përgatitjes së raporteve të analizimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit me karakter urgjent, të cilat janë trajtuar me përparësi nga KLP-ja, dhe i janë vënë në dispozicion KPK-së në një kohë shumë të shpejtë, me qëllim ecurinë e procesit dhe shmangien e vonesave.

## **8. Marrëdhëniet me Kuvendin**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi ka vijua marrëdhëniet institucionale me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sikurse ishte dhe raportimi i datës 18.05.2022, ku Kryetari i KLP-së zoti Alfred Balla, Zëvendëskryetari zoti Tartar Bazaj dhe Sekretari i Përgjithshëm, zoti Emis Çërava raportuan pranë Kuvendit të Shqipërisë, në Komisionin për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për Raportin Vjetor të veprimtarisë së Këshillit gjatë vitit 2021.

Ndërsa, më datë 14.07.2022, Kryetari i KLP-së zoti Alfred Balla relatoi në seancën plenare të Kuvendit mbi veprimtarinë e KLP-së për vitin paraardhës, e cila më pas u përmbyll me miratimin e Rezolutës *“Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2021”*, po në të njëjtën datë.

### **D. Transparenca ndaj publikut dhe mediave**

Transparenca ndaj medias dhe publikut në sistemin e drejtësisë në përgjithësi, por edhe në atë të prokurorisë në veçanti, është kthyer në një nga momentet më të rëndësishme të punës së KLP-së. Duke përmbushur detyrimin ligjor në lidhje me transparencën institucionale, KLP-ja, edhe gjatë vitit 2022, i ka dhënë një vëmendje të veçantë komunikimit publik mes tij dhe palëve të treta, përfshirë këtu median, institucionet e tjera publike, organizatat, përfaqësitë ndërkombëtare, etj. Me qëllim rritjen e besimit të publikut tek institucionet, KLP-ja ka treguar gjithnjë një kujdes të veçantë në jetësimin e një marrëdhënieje të konsoliduar mes institucionit dhe partnerëve mediatikë, duke rritur në këtë mënyrë edhe nivelin e transparencës.

Për këtë arsye, gjatë vitit 2022, KLP-ja ka ndërmarrë një sërë hapash për të forcuar më tej komunikimin me publikun, median dhe aktorët e tjerë, duke komunikuar në mënyrë sistematike përmes medimeve të ndryshme, ku ka pasqyruar me transparencë dhe përgjegjësi të plotë, të gjithë veprimtarinë e saj, në përmbushje edhe të detyrimit ligjor që burojnë nga ligji Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

KLP-ja është kujdesur që media, publiku dhe të gjithë të interesuarit, të kenë akses të plotë sa i takon veprimtarisë së tij, përmes platformës on-line. Në kuadër të transparencës institucionale, janë pasqyruar të gjitha mbledhjet plenare, seancat dëgjimore dhe aktiviteti i përditshëm i KLP-së. Vlen të theksohet se jo vetëm mbledhjet, por të gjitha aktet dhe dokumentet e rëndësishme që prodhohen nga ky institucion, gjenden të pasqyruar për publikun e gjerë në faqen zyrtare të këtij institucioni. Gjithashtu, në respektim edhe të bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, platforma e komunikimit institucional online ka qenë e aksesueshme edhe për të ftuarit, përfaqësues nga institucione si Ministria e Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm apo edhe programet e monitorimit OPDAT dhe media.

Në vijim të përmirësimit të komunikimit institucional, gjatë vitit 2022, KLP-ja ka gjeneruar komunikimin me publikun, duke ardhur më pranë tij përmes krijimit të platformave të reja komunikuese, si llogaria zyrtare në Twitter, Instagram apo edhe kanali zyrtar në Youtube. Sikundër është proceduar edhe me faqen zyrtare të internetit, [www.klp.al](http://www.klp.al), edhe komunikimi në rrjetet sociale ka sjellë një qasje dhe afërsi më të madhe me publikun, duke pasqyruar aty të gjithë aktivitetin e Këshillit gjatë gjithë vitit 2022 përmes publikimeve multimediale. Periodikisht në një hark njëmuor realizohet përmbledhja e publikimeve të KLP-së, përmes publikimit të një Buletini Informativ, i cili vjen për publikun në gjuhën shqipe dhe atë angleze.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022, KLP-ja ka miratuar rregulloren “Për komunikimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Median”, me qëllim garantimin e pasqyrimin të qëndrimit institucional të Këshillit, në funksion të transparencës në komunikimin me median dhe publikun. Kjo rregullore përcakton parime, rregulla dhe procedura të veçanta, pjesë e rregullave për marrëdhëniet me publikun, komunikimin e ligjshëm, transparent, të përgjegjshëm dhe profesional të Këshillit me median e shkruar dhe elektronike, si dhe me çdo përfaqësues të saj.

KLP-ja e ka cilësuar gjithnjë bashkëpunuese marrëdhënien me median, sikurse mbulimin mediatik që ajo i ka bërë punës së tij, e vlerëson si një mbështetje të pazëvendësueshme në rrugën drejt konsolidimit të besimit të publikut në institucionet e drejtësisë. Për të përmirësuar akoma më shumë bashkëpunimin me median, KLP-ja ka mundësuar edhe hartimin e një Model Kërkese për Informim, për të gjitha ato media që bëhen pjesë e aktiviteteve dhe agjendës mediatike të Këshillit.

Në zbatim të ligjit Nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, po ashtu dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore të specifikuara nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, KLP-ja, përgjatë vitit 2022 ka siguruar aksesimin e informacionit të kërkuar nga çdo individ, institucion apo njësi tjetër, duke garantuar kthim përgjigjeje, delegim apo orientimin e kërkesave për informacion të publikut, brenda afateve ligjore.

Konform Urdhrit Nr.187, datë 18.12.2020, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, KLP-ja ka vazhduar përditësimin e disa prej rubrikave të Programit të Transparencës, publikuar në faqen zyrtare të internetit, sipas ndryshimeve të ndodhura përgjatë kësaj periudhe.



Sipas këtij Urdhri, është përshtatur “Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve on-line”, në përputhje edhe me kushtet teknike të faqes zyrtare. Në këtë kategori janë publikuar kërkesat për informacion të ardhura në adresë të Këshillit gjatë gjithë vitit 2022.

Përgjatë kësaj periudhe 1-vjeçare, KLP-ja ka marrë dhe trajtuar një numër prej 35 kërkesash, në formatin elektronik dhe përmes shërbimit postar, të cilat janë trajtuar dhe kanë marrë përgjigje brenda afateve ligjore, ku një pjesë e mirë e tyre vijnë nga operatorë mediatikë, studio ligjore dhe përmbartimore dhe po ashtu qytetarë, lidhur me punën e Këshillit dhe mbi çështje specifike që përfshijnë Këshillin. Po ashtu, ka pasur kërkesa për informacion edhe nga organizata jofitimprurëse apo institucione të tjera.

Në fund të vitit 2022 janë rishikuar edhe disa nga rubrikat e tjera të faqes zyrtare të internetit të Këshillit, pjesë të Programit të Transparencës, ku është paraqitur një prezantim më i plotë me anëtarët e Këshillit dhe strukturën organizative, struktura dhe nivelet e pagave, detajimi i buxhetit, projekt-buxheti afat-mesëm etj. Kuadri ligjor po ashtu ka pësuar përditësime dhe plotësime me aktet nënligjore, që janë një punë e vazhdueshme e Këshillit, si dhe raportet vjetore dhe marrëdhëniet me institucionet e bashkëlidhura.

Po ashtu, nën kryesimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale po punohet për formatin e ri të “Regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit” (REKPDI), mekanizëm i Regjistrin Elektronik të Pyetje-Përgjigjeve, instrument i cili do të krijohet, mbështetur në VKM Nr.145, datë 13.03.2018, “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit””, nën administrimin dhe mbikëqyrjen e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

#### **E. Propozime për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe adresimin e problematikave të sistemit**

Gjatë veprimtarisë së Këshillit ka lindur nevoja për adresimin e disa problematikave, kryesisht me adresimin e problemit të plotësimit të vakancave të sistemit, si dhe përmirësimi i kuadrit ligjor në përgjithësi. Në këtë aspekt janë bërë disa propozime për ndryshime ligjore ku do të veçonim:

#### **9. Programi i Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës me kohëzgjatje 3 vjet të bëhet në 2 vjet, për një periudhë tranzitore**

Sipas këtij propozimi synohet vendosja e një parashikimi të ri ligjor që të rregullojë, përjashtimisht, për një *periudhë tranzitore*, zhvillimin e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në një kohëzgjatje prej 2 vitesh. Kjo nënkupton shkrirjen e vitit të praktikës para-profesionale me vitin e praktikës profesionale (*respektivisht, shkrirjen e vitit të dytë me vitin e tretë*), të programit aktual të studimit në Formimin Fillestar.

Periudha tranzitore sipas këtij propozimi do të ishte, me fillim nga viti akademik 2020 - 2021 deri përfundimin e mandatit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Vëmë në dukje se, rregullimet aktuale ligjore të programit 3-vjeçar të Formimit Fillestar do të vijojnë të zbatohen për studentët e Vitit të I, Vitit të 2 dhe Vitit të 3, që aktualisht ndjekin studimet si dhe për studentët që do të ndjekin studimet pas përfundimit të periudhës tranzitore (përfshirë vitin akademik 2020 - 2021).

Mënyra e pranimit, zhvillimit të studimeve dhe vlerësimit të kandidatëve për magjistratë (prokurorë ose gjyqtarë) rregullohet në nenet 263 e vijues të ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar.

Në nenin 263, të Ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Formimi fillestar i kandidatëve për magjistratë përfshin një periudhë trevjeçare që përbëhet nga:

a) një vit program teorik që synon të rrisë njohuritë në lëndë të ndryshme të së drejtës;

**b) një vit program praktik paraprofesional, që synon të rrisë aftësitë praktike të kandidatëve si gjyqtarë dhe prokurorë nën kujdesin e shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori me kualifikim të lartë;**

**c) një vit praktikë profesionale që do të organizohet sipas mënyrës dhe afateve të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.**

2. Programi i trajnimit, i parashikuar sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, është i përbashkët për të gjithë kandidatët dhe organizohet, ndiqet e drejtohet nga Shkolla e Magjistraturës. Viti i praktikës paraprofesionale zhvillohet sipas profileve që ka zgjedhur kandidati si gjyqtar ose prokuror”

Në nenin 268 të këtij ligji, përcaktohen kriteret dhe procedurat për vlerësimin e formimit fillestar për kandidatët për magjistratë, referuar programit aktual 3-vjecar të Formimit Fillestar. Këto kriteret dhe procedura mund të aplikohen edhe për vlerësimin e kandidatëve për magjistratë në periudhën tranzitore të programit të Formimit Fillestar me kohëzgjatje 2-vjecare.

Ndërsa, në nenin 269, të ligjit, përcaktohet mënyra e vlerësimit të praktikës profesionale për kandidatët për magjistratë, referuar programit aktual 3-vjecar të Formimit Fillestar. Kjo mënyrë vlerësimi mund të aplikohet edhe për vlerësimin e kandidatëve për magjistratë në periudhën tranzitore të programit të Formimit Fillestar me kohëzgjatje 2-vjecare.

Në nenet 19, pika 1, dhe 33, të Ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, rregullohen çështja e trajnimit me bursë të kandidatëve për magjistratë si dhe mënyra e kryerjes së praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë.

Duke qenë se, për periudhën tranzitore, programi i Formimit Fillestar do të zhvillohet në 2 vite sugjerohet që, niveli i bursës gjatë vitit të dytë në periudhën tranzitore të jetë 45 për qind të pagës bruto fillestare të magjistratit. Po ashtu, rregullat e tjera të nenit 19, do të zbatohen për kandidatët për magjistratë në periudhën tranzitore.

Po kështu, në nenin 33, të këtij ligji, parashikohet mënyra e kryerjes së praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë. Në pikën 1, të këtij neni parashikohet se:

*“1. Kandidatët gjyqtarë dhe kandidatët prokurorë kryejnë praktikën profesionale, përkatësisht, në gjykata dhe në prokurori, në vitin e tretë të formimit fillestar. Praktika profesionale zgjat 12 muaj, duke filluar në muajin korrik dhe përfundon në muajin qershor të vitit pasardhës....”*

Për të njëjtën arsye si më sipër është e nevojshme që, të shtohet një rregullim i ri ligjor sipas së cilit, kandidatët gjyqtarë dhe kandidatët prokurorë të kryejnë praktikën profesionale në periudhën përkatëse të vitit të dytë të Programit Fillestar në periudhën tranzitore, sipas rregullave të nenit 33, të këtij ligji.

## 10. Rregullimi i procedurës së procedimit disiplinor

Problematika që adreson ndryshimi i mësipërm, ka lindur në gjatë praktikës tashmë disa vjeçare të drejtim të procedimeve disiplinore, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë për shkak të parashikimit në fjalinë e parë, të pikës 1, të nenit 192 ka ankimuar vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në Gjykatën Administrative të Apelit. Konkretisht, fjalia e parë e pikës 1 e nenit 192 parashikon se: *“Ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj. Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi prokurorët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese.”*

Ne vlerësojmë se, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk mund të ankohet dhe të kërkojë vendosjen e masës disiplinore ndaj një magjistrati prokuror nga Gjykata Administrative për shkak se Gjykata Administrative e Apelit nuk mund të ndryshojë vendimin e Këshillit duke vendosur një masë disiplinore ndaj një magjistrati. Ne vlerësojmë se e drejta për vendosjen e masave disiplinore ndaj prokurorëve është një e drejtë ekskluzive e Këshillit, dhënë nga Kushtetua e Republikës së Shqipërisë mbi bazën e neneve 149 dhe 149/a të saj.

Vendimmarrja e KLP-së, ushtrohet në kuadër të një procesi të rregullt nga pikëpamja procedurale, duke garantuar respektimin e parimeve për një proces të rregullt administrativ. Kjo vendimmarrje, duke pasur parasysh edhe konfigurimin strukturor të Këshillit (6 anëtarë prokurorë dhe 5 joprokurorë që vijnë nga fusha të ndryshme) shtrihet përtej vlerësimit apo kualifikimit si shkelje disiplinore të një sjellje të caktuar. Ajo ndikohet në mënyrë të pashmangshme edhe nga detyrat dhe funksionet e tjera të KLP-së, në kuadër të menaxhimit apo administrimit të sistemit të Prokurorisë në tërësinë e tij, veçanërisht ato që lidhen me sistemin e vlerësimit dhe të karrierës. Secili anëtar i Këshillit merr vendimet e tij, mbi bazën e bindjes së tij të brendshme e cila normalisht mund dhe duhet të lidhet me grupin e interesit të cilin secili prej anëtarëve përfaqëson dhe nga i cili është zgjedhur në këtë Këshill. Ky ka qenë edhe qëllimi i këtij konfigurimi të përbërjes së KLP-së sanksionuar nëpërmjet normave Kushtetuese. Për këto arsye Gjykata Administrative e Apelit gjithmonë sipas vlerësimit tonë nuk mund dhe nuk duhet të marrë kompetencën e vendosjes së masave disiplinore ndaj magjistratëve, kompetencë e cila deri më sot është ushtruar vetëm nga KPK (në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar), Këshillat (KLP dhe KLGJ), si dhe nga KPA, si i vetmi organ i cili sipas Kushtetutës ka juridiksion disiplinor ndaj magjistratëve.

Edhe vetë procesi i rivlerësimit kalimtar, pjesë reformës në drejtësi, është hartuar mbi bazën e parimit se çështjet disiplinore shqyrtohen nga organe të posaçme sikurse është KPK, dhe ankimohen në KPA, organe të cilat nuk duhet dhe nuk mund të jenë pjesë e sistemit gjyqësor.

Për të njëjtën arsye, edhe procedimet disiplinore të zhvilluara në bazë të ligjit nr. 96/2016, Për statusin, zhvillohen nga organe si KLP dhe KLGJ, të ngritura mbi bazën e po të njëjtës pakete ligjesh që normojnë atë që quhet reformë në drejtësi, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë sistemit gjyqësor, për të garantuar objektivitet në gjykim dhe shmangur edhe konfliktin e mundshëm të interesit (*në këtë rast të gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit*). Në këto kushte, për të ruajtur të njëjtin standard me masat disiplinore të dhëna nga KPK, edhe ankimimet ndaj vendimeve disiplinore duhet të gjithashtu të shqyrtohen nga KPA.

Në të kundërt Gjykata e Administrative e Apelit do të gjendet në të ardhmen përpara vlerësimit të sjelljes profesionale të gjyqtarëve të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke vlerësuar sipas rastit edhe zbatimin e gabuar të ligjit nga ana e Gjykatës së Lartë apo për më tepër paaftësinë e dukshme profesionale të tyre (*sipas përcaktimeve të nenit 101, pika 1 germa b*) e ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin” i ndryshuar”, ndërkohë që nga ana tjetër është e detyruar

të zbatohet pikërisht këto vendime të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në të cilën Gjykata Administrative e Apelit ka konstatuar se janë marrë në shkelje të rëndë të ligjit.

Nga ana tjetër para cilës gjykatë do të ankohej magjistrati nëse eventualisht masën disiplinore e jep gjykata administrative e apelit. (*normalisht vendimi i gjykatës ankimohet në një gjykatë më të lartë pra në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë*). D.m.th, nëse e njëjta masë disiplinore do jepej nga Këshillat, gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit do ishte Gjykata Kushtetuese nëpërmjet KPA si dhomë e kësaj gjykate, ndërsa në rast se për të njëjtën çështje, e njëjta masë disiplinore do jepej nga gjykata administrative e apelit, po i njëjti magjistrat do ankohej në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Ne vlerësojmë se ligjvënësi nuk mund të ketë zgjidhur në mënyrë konfuze një të drejtë kaq themelore siç është e drejta e ankimit të palëve ndaj një vendimi me karakter disiplinor.

## **11. Shfuqizimi i parashikimit ligjor për kryerjen e verifikimit të pasurisë dhe figurës për të diplomuarit në Shkollën e Magjistraturës**

Në nenin 148/ç, pika 1, të Ligjit nr. 8417, dt. 21.10.1998, "*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, parashikohet se: "*1. Prokurorë mund të jenë shtetasit shqiptarë, që emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.*"

Në nenin 34, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, parashikohet detyrimi i Këshillave për kryerjen e verifikimit të pasurisë dhe figurës, në përputhje me rregullat e nenit 32, të këtij ligji. Ndërsa, në nenin 35, pika 1, të këtij ligji, përcaktohen kriteret për emërimin e kandidatëve magjistratë të diplomuar, ku thuhet se:

*"1. I diplomuari emërohet magjistrat nëse plotëson njëkohësisht këto kriteret:*

- a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme;*
- b) është vlerësuar minimalisht "mirë" për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar;*
- c) ka kaluar sërish verifikimin e pasurisë dhe figurës, të kryer nga Këshillat në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji."*

Praktika e deritanishme e Këshillave tregon për vonesa të konsiderueshme në kohë për emërimin e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës, si magjistratë dhe caktimin e tyre në pozicion. Këto vonesa janë shkaktuar kryesisht nga koha e gjatë për verifikimin e pasurisë dhe figurës si dhe kthimi i përgjigjeve nga organet ndihmëse sipas nenit 32, pika 2, të këtij ligji (ILDKPKI, organet tatimore dhe doganore, zyrat e prokurorisë, etj). Vonesat e shkaktuara kanë rezultuar në kosto financiare të ndjeshme të vendosura nga vendimet gjyqësore në shqyrtim të ankimeve të të diplomuarve të emëruar me vonesë për shkakun e mësipërm.

Përsa i përket emërimit të studentëve si magjistratëve prokurorë, pas diplomimit të tyre, Këshilli i Lartë i Prokurorisë kryen verifikimin e pasurisë dhe të figurës për çdo kandidat për prokuror përpara se të filloj programin e formimit fillestar dhe pasi përfundon me sukses këtë program. Në praktikë është konstatuar që për shkak të procesit të riveifikimit të pasurisë dhe figurës, krijohet artificialisht një vonesë ku kandidatët për prokuror nuk mund të emërohen pa u ri kryer sërish verifikimi i cili ndërvarret nga disa institucione të tjera, duke bërë që vakancat në sistem të mbeten të paplotësuara dhe për më tepër të rëndojnë edhe një faturë financiare për mos emërimin në kohë të magjistratëve të rinj.

Konkretisht për prokuror për vitin 2018, ka rezultuar se 6 kandidatët për prokuror, të cilët kanë përfunduar me sukses vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, janë mundur të emërohen nga KLP vetëm në Korrik të vitit 2019, pra pas një viti nga momenti i diplomimit;

Kandidatët për prokuror që kanë mbaruar shkollën në Korrik të vitit 2019 janë emëruar në Shkurt të vitit 2020, pra pas 7 muajsh nga momenti i diplomimit;

Kandidatët për prokuror të cilët kanë përfunduar studimet në Korrik të vitit 2020, janë emëruar në tetor të vitit 2020, pra pas 4 muajve nga momenti i diplomimit.

Sikurse shihet vonesat për përfshirjen në sistem të të diplomuarve kanë qenë të konsiderueshme, në raport me nevojën imediatë që paraqitet në këtë moment, pra përmendur këtu edhe një faturë financiare e shprehur si detyrim i vendosur nga gjykata, për pagesën e pagave të këtyre të diplomuarve nga momenti i diplomimit deri në emërimin e tyre. (në total 150 paga bruto të kategorisë G3 në një vlerë totale).

Duke ju referuar edhe praktikës së deri tanishme nuk ka rezultuar në asnjë rast që një kandidat për prokuror të ketë ngelur gjatë filtrit të verifikimit që Këshilli ka bërë pas diplomimit. Mendoj që duhet të jetë e njëjta situatë edhe për KLGJ-në.

Për këtë shkak, duke u nisur nga burimet e kufizuara njerëzore por edhe nga fakti që pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, kandidatët për prokuror kanë kaluar me sukses verifikimin fillestar të pasurisë dhe të figurës si dhe janë në mënyrë vazhduese objekt kontrolli nga Komisioni Disiplinor i Shkollës së Magjistraturës, jemi të mendimit që ri-verifikimi pas diplomimit duhet të shfuqizohet me qëllim përfshirjen në sistem sa më parë të këtyre magistratëve.

Për të shmangur vonesat në emërimin si magistratë, kostot financiare që shoqërojnë këtë proces sipas rregullimit aktual ligjor, duke patur parasysh faktin se kandidatët për magistratë verifikohen përpara se të pranohen në Formimin Fillestar të Shkollës së Magjistraturës si dhe gjatë çdo procesi të ngritjes në detyrë sipas këtij ligji, faktin se magistratët janë subjekt i deklarimit të pasurisë sipas Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, sugjerojmë heqjen e kushtit ligjor për verifikimin e pasurisë dhe figurës për të diplomuarit në Shkollën e Magjistraturës.

## **12. Shtimi i funksionit të këshilltarit ligjor në prokuroritë e shkallëve të para dhe të apelit të juridiksion të përgjithshëm**

Ky propozim do të ndihmonte në rritjen e rendimentit në punën e prokurorit, duke adresuar problematikën e mbingarkesës së sistemit të prokurorisë. Krijimi i mundësisë për të gjithë ndihmësit ligjor me mbi 5 vjet përvojë pune në këtë detyrë që kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, të futen pa konkurs në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në profilin gjyqtar, ndërsa ndihmësit ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme në profilin prokuror. Një përcaktim i tillë në ligj jo vetëm që do hapte rrugën e karrierës për ndihmësit ligjor në detyrë, por do mundësonte që në radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve të futeshin persona, të cilët do kishin një formim më të mirë teorik e praktik dhe më të përgatitur në kryerjen e detyrës së gjyqtarit, pasi do të vinin në jetë të gjithë njohuritë dhe aftësitë profesionale të krijuara gjatë punës së përditshme në gjykatë. Gjithashtu edhe ky propozim do të mundësonte rikuperimin sa më të shpejtë të një pjese qoftë edhe të vogël të vakancave të sistemit.

## **F. Veprimtaria financiare dhe administrative**

### **13. Struktura dhe organigrama e KLP-së**

KLP me Vendimin Nr.36, datë 06.03.2019, *“Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë”*, ka miratuar strukturën organizative, në përputhje me nenin 178, të Ligjit për Qeverisjen, ku janë përcaktuar qartë mënyra e organizimit dhe njësitë mbështetëse të administratës së KLP-së.

Struktura organizative e KLP-së është e përbërë nga 65 punonjës dhe në fund të vitit 2022, në KLP ka pasur 64 punonjës faktik. KLP-ja në mbledhjen plenare të datës 09.05.2022, me vendimin Nr.96, ka miratuar relacionin e Komisionit të Buxhetit, ku është marrë në shqyrtim dhe ndryshimi i strukturës së Këshillit.

Pas tre vitesh eksperience dhe në kuadër të përmirësimit të punës, realizimit të objektivave dhe qëllimeve të institucionit, duke iu referuar nenit 178, të Ligjit për Qeverisjen, u pa e domosdoshme ristrukturimi i njërive sipas përcaktimeve të këtij neni, duke synuar një strukturë më të përshtatshme me objektivat e planifikuara për të ardhmen, duke analizuar dhe problematikat që janë hasur deri më sot me strukturën aktuale.

Gjithashtu, u mor parasysh edhe fakti që Ligji për Qeverisjen shprehet specifikisht se KLP-ja duhet të funksionojë sipas përcaktimeve të mëposhtme: *Në strukturën aktuale pikat ç, d, dh, e, të nenit 178 nuk organizohen si njësi. Ato përfshihen në fushën e veprimtarisë së një nëpunësi (apo të Këshilltarit për Etikën), ose mungojnë fare, siç është rasti i njësisë mbështetëse për trajnimin e prokurorëve dhe të nëpunësve civilë të sistemit të prokurorisë.*

Për sa më sipër, KLP-ja, më datë 02.11.2022, ka parashtruar përpara Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, kërkesat buxhetore për PBA, për periudhën 2023-2025, duke kërkuar ndër të tjera rritjen e numrit të personelit në 78 punonjës.

Kërkesat për shpenzimet buxhetore të PBA për vitet 2023-2025 janë pranuar pjesërisht nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, duke miratuar organikën prej 72 punonjësish për KLP-në. Rikonfigurimi i KLP-së pritet të kryhet gjatë vitit 2023.

### **14. Procesi i rekrutimit të nëpunësve civilë**

Procedurat e rekrutimit të nëpunësve të KLP-së janë kryer sipas ligjit Nr.152/2013, *“Për Nëpunësin Civil i ndryshuar*, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.242, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar*, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.243 datë 18.03.2015 *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar.*

Gjatë vitit 2022 janë kryer procedurat si vijon më poshtë;

1. Numri i të rekrutuarve në shërbimin civil për periudhën Janar-Dhjetor 2022 është 2 (dy) dhe konkretisht;
  - a. Pranim nga jashtë shërbimit civil, në pozicionin Specialist Arkiva;
  - b. Pranim nga jashtë shërbimit civil, në pozicionin Këshilltar në Njësinë e Mbështetjes së Komisioneve.

2. Numri i të rekrutuarve për punonjësit administrativë për periudhën Janar-Dhjetor 2022 është 2 (dy).
  - a. Punonjës Informacioni;
  - b. Shofer.
3. Numri i të rekrutuarve për funksionarët politikë në Kabinetin e Kryetarit për periudhën Janar-Dhjetor 2022 është 5 (pesë).
  - a. Drejtor Kabineti;
  - b. Këshilltar;
  - c. Këshilltar;
  - d. Këshilltar;
  - e. Këshilltar.



### 15. Buxheti i negociuar dhe alokuar për vitin 2022

Buxheti vjetor i KLP-së është miratuar në përputhje me Ligjin Nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022" i ndryshuar, Udhëzimin Nr.9, datë 20.03.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", dhe Udhëzimin plotësues Nr.1, datë 10.01.2022, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022", i ndryshuar.

Burimi kryesor i financimit të KLP-së është buxheti i shtetit. KLP-ja nuk gjeneron të ardhura të tjera. Ligji për Buxhetin ka miratuar buxhetin vjetor për periudhën Janar-Dhjetor 2022:

NR.	Zërat e Shpenzimeve	Janar - Dhjetor 2022		
		PLAN i rishikuar	FAKT	REALIZIMI %
1	PAGA	103,009	102,730	99%
2	SIGURIME SHOQËRORE	12,910	12 899	100%
3	MALLRA DHE SHËRBIME	26,626	26,358	99%
4	INVESTIME	8,000	7 835	98%
	Total	142,545		99%


### STRUKTURA BUXHETORE PËR VITIN 2022



Gjatë vitit 2022 plani buxhetor dhe faktik ka qenë si më poshtë:

NR.	Zërat e shpenzimeve	JANAR - DHJETOR 2022		
		Plani i Rishikuar	FAKT	REALIZIMI %
1	Paga	103 009	102.730	100%
2	Sigurime Shoqërore	12.910	12 899	100%
3	Mallra dhe shërbime	26 626	26 358	99%
4	Investime	8 000	7 835	98%

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë grafike krahasimore të dhënat e realizimit të buxhetit për periudhën Janar- Dhjetor 2022.



Nga pasqyra e mësipërme rezulton se, buxheti për periudhën janar-dhjetor 2022 është realizuar në masën 99%, i ndarë si më poshtë:

1. Paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore (600+601) **realizuar 99%**. Ky realizimi konsiderohet shume i mirë. Vlen të theksohet se me buxhetin e këtij zëri janë kryer dhe pagesat e prapambetura sipas pagesave të pagës referuese bazë, për diferencë në vlerën prej 14 000 lekë (132 100-118100), për anëtarët e KLP-së, për periudhën 01 janar 2019 deri 28 maj 2021, datë në të cilën ka hyrë në fuqi ligji Nr.50/2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
2. Shpenzimet operative (602) **realizuar 97%**. Realizimi i këtij zëri vjen si rezultat i kompletimit të stafit administrativ, duke ndikuar në realizimin e procedurave të prokurimit për mallra dhe shërbime të nevojshme për mirëfunksionimin e institucionit.
3. Investimet publike (231) **janë realizuar 98%** e fondit të planifikuar, në zërat si më poshtë vijon:
  - a. Blerje automjete për anëtarët e KLP-së;
  - b. Ndarje funksionale zyre.

## 16. Nevojat buxhetore

Artikujt	Buxheti		PBA 2024- 2025	
	2022	2023	2024	2025
<b>Paga (600-601)</b>	119 917,0	132 517,0	132 517	132 517
<b>Korrente të tjera (602-606)</b>	34 233,0	25 083,0	21 483	21 483
<b>Kapitale (230-232)</b>	8 000,0	15 000,0	10 000,0	10 000,0
<b>Totali</b>	164 000,0	172 600,0	164 000,0	164 000,0



Zërat buxhetore të pagave dhe sigurimeve shoqërore janë përllogaritur në bazë të strukturës aktuale të KLP-së prej 65 punonjësish. Zëri i mallrave dhe shpenzime është përllogaritur bazuar në kërkesat e vitit të mëparshëm ku realizimi ka qenë 99 %.

Gjithashtu i jemi referuar edhe kontratave të reja që Ndërmarrja Industriale Nr.1, e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si institucioni përgjegjës që ka në ngarkim Godinën “Poli i Drejtësisë”, ka parashikuar.

Ndërkohë, zëri investime është përllogaritur referuar nevojave që KLP-ja ka për pajisjen me automjete për secilin anëtar, si dhe për ndarje funksionale të ambjenteve të zyrave të administratës dhe mobilimin e tyre.

E parashtruar këtu fakt për të pasur vëmendjen e shtuar të Kuvendit ndaj kërkesave buxhetore të KLP-së, pasi ato lidhen drejtpërdrejtë me zbatimin e reformës në drejtësi, ku KLP-ja është një faktor i rëndësishëm. Theksojmë se, përkundër llogaritjeve të bëra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi bazën e buxhetit të këtij viti, kërkesat buxhetore të KLP-së janë rrjedhojë e përllogaritjes së funksioneve të Këshillit, bazuar në ushtrimin e këtyre funksioneve gjatë vitit 2022 e në vazhdim.

Për më tepër, nevojat e këtij institucioni kërkojnë burime financiare suplementare për investime, pajisje, teknologji informative, trajnime, por edhe mallra e shërbime cilësore, të cilat rrisin cilësinë dhe efikasitetin e punës së institucionit.

## **17. Proceset gjyqësore**

Gjatë periudhës Janar 2022 – Dhjetor 2022, proceset gjyqësore në të cilët KLP-ja ka qenë palë në gjykim janë shtuar në mënyrë të konsiderueshme. Ndryshe nga praktika e viteve të shkuara, gjatë këtij viti KLP-ja ka qenë e thirrur në cilësinë e palës së paditur në 22 procese gjyqësore, në cilësinë personit të tretë në 52 procese gjyqësore, si dhe ka investuar gjykatën në cilësinë e paditësit në 2 (dy) procese gjyqësore, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Përveç sa më sipër, KLP-ja ka ndjekur 2 procese gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit, 1 proces në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (dhoma civile) dhe 1 proces në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (dhoma penale). KLP-ja ka ndjekur gjithashtu 1 proces në Gjykatën Kushtetuese dhe 2 procese në KPA.

Gjithashtu, 5 çështje janë ankimuar gjatë vitit 2022, pas vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe 5 çështje janë rekursuar/kundër rekursuar, pas vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit.

Pothuaj të gjithë proceset ku KLP-ja është thirrur si palë e tretë kanë për objekt "Përfitim diference page/detyrim page", si rezultat i përllogaritjes së gabuar të pagës së magjistratëve në Republikën e Shqipërisë. Po kështu, edhe një pjesë e konsiderueshme e proceseve ku KLP-ja është thirrur në cilësinë e të paditurit, kanë të njëjtin objekt.

Më poshtë do të jepet shpjegim për tipologjitë kryesore të proceseve gjyqësore ku KLP-ja ka marrë pjesë gjatë vitit 2022.

1. Gjatë vitit 2022 ka patur një fluks procesesh gjyqësore me objekt "Përfitim diference page/detyrim page", i cili ka ardhur si rezultat i një auditimi që Kontrolli i Lartë i Shtetit (më tej, KLSH) ka kryer në KLGJ, me objekt “Mbi auditimin tematik të

përputhshmërisë, të ushtruar në bazë të autorizimit për verifikimin e përllogaritjes së pagave, me fokus të veçantë ndër të tjera vjetërsinë në punë, si dhe kuadrin ligjor e rregullator mbi të cilin mbështetet përllogaritja e tyre në Këshillin e Lartë Gjyqësor”. Në përfundim të këtij auditimi, KLSH ka arritur në rekomandimin që: Për të gjithë magistratët, pavarësisht nga pozicioni i tyre i punës (kategoritë G1, G2 dhe G3), paga referuese bazë të përllogaritjet mbi bazën e plotë të pagës së Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme në Kryeministri, e cila përbëhet nga paga e grupit, plus shtesën e pagës (132,100 = 14,000 + 118,100) dhe jo siç përllogaritjet aktualisht, vetëm mbi shtesën për pozicion (118,100). Pagesa duhet të bëhet duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (ose emërimit, për personat e punësuar pas kësaj date) dhe të përllogaritjet për të gjithë periudhën, bashkë me të gjitha shtesat dhe pakësimet, sipas rastit. 2. Për pozicionet e tjera, si kryetar i seksionit, magistrat i shtypit, këshilltar i etikës ose magistrat udhëheqës (në qoftë se këto pozicione aplikohen), të përllogaritjet shtesa prej 5% mbi pagën bazë të grupit (G1, G2 apo G3, sipas rastit).

2. Për pozicionet e tjera, si kryetar i seksionit, magistrat i shtypit, këshilltar i etikës ose magistrat udhëheqës (në qoftë se këto pozicione do të aplikohen në të ardhmen), të përllogaritjet shtesa prej 5% mbi pagën bazë të grupit (G1, G2 apo G3, sipas rastit). Në vazhden e proceseve që po shtoheshin, KLP-ja doli me vendimin Nr.232, datë 16.09.2022, *“Për rillogaritjen e pagave për anëtarët dhe ish-anëtarët e KLP, për periudhën 01.01.2019- 28.05.2021”*. Ndërkohë, me kërkesën e datës 01.07.2022, Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 12, pika 5, shkronja “a”, të ligjit Nr.96/2016, të ndryshuar me ligjin Nr.50/2021, si dhe të nenit 1, pika 7, paragrafi i dytë, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të ligjit Nr.8097/1996, të ndryshuar me ligjin Nr.166/2020. Gjykata Kushtetuese mori në shqyrtim kërkesën e Unionit dhe vendosi: 1. *Pranimin e kërkesës.* 2. *Shfuqizimin e nenit 12, pika 5, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me nenin 2, pika 1, të ligjit nr. 50/2021, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.*
3. Shfuqizimin e nenit 1, pika 7, paragrafi i dytë, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996 *“Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”*, të ndryshuar me nenin 1, pika 1, të ligjit nr. 166/2020, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
4. Pavarësisht sa më sipër, vijojnë proceset gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në pritje të një zgjidhje ligjore nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Kuvendit, sa i përket përllogaritjes së pagave, pas shpalljes së antikushtetueshmërisë së neneve të sipërcituara në dispozitiv.
5. Një prej detyrave të caktuara nga Ligji për Statusin për KLP-në, është verifikimi i pasurisë dhe figurës për kandidatët që konkurrojnë për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magistraturës, profili prokuror. Sa i përket vitit akademik 2022-2023, KLP-ja ka ndaluar 1 (një) kandidat për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magistraturës. Ky i fundit i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në muajin Dhjetor 2022, e cila pritet ta shqyrtojë kërkesëpadinë gjatë vitit 2023. Gjatë procesit të verifikimit, KLP-ja ka marrë disa vendime të tjera ndalimi për pranimin e kandidatëve në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magistraturës. Për vitin akademik 2020-2021 dhe për vitin akademik

2021-2022, kandidatët e ndaluar i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ku kjo e fundit, në 2 (dy) raste ka rrëzuar kërkesë padinë dhe në 1 (një) rast ka vendosur pranimin e saj. KLP-ja, sipas llojit të vendimmarrjes së gjykatës, ka ushtruar të drejtën e rekursit dhe kundër-rekursit, brenda afateve ligjore. Për të dy vendimet e rekursuara, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Një prej këtyre vendimeve të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është duke u shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese, vendimi i së cilës pritet të jetë në fillim të vitit 2023, pas ankimit kushtetues të ushtruar.

6. Në këtë raport, janë sqaruar në mënyrë të detajuar rastet e procedimeve disiplinore të shqyrtuara në KLP gjatë vitit 2022. Ndërsa në këtë kapitull, do të sqarohen më tej, rastet e ankimura të vendimmarrjeve të KLP-së nga ana e magjistratëve, lidhur me masat disiplinore të vendosura/ apo rrëzuara nga ana e tij. Gjatë vitit 2022, në KLP janë paraqitur tre kërkesa të ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor, shoqëruar me masën disiplinore të propozuar nga ana e tij, “Shkarkim nga detyra”, për të cilat, KLP-ja ka vendosur pranimin e kërkesës së ILD dhe dhënien e kësaj mase disiplinore për tre prokurorë. Në të tre rastet, është ushtruar e drejta e ankimit pranë KPA-së. Në një rast, KPA-ja ka vendosur mospranimin e ankimit të magjistratit kundër vendimit të KLP-së për caktimin e masës disiplinore. Në dy rastet e tjera, nga ana e KPA-së pritet një vendimmarrje në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, pa praninë e palëve, gjatë vitit 2023.
7. Sa i përket një procedimi disiplinor të përfunduar në fund të vitit 2020, për të cilin KLP-ja vendosi rrëzimin e kërkesës së ILD-së, për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj një prokurori, sikurse jemi shprehur në raportin vjetor të vitit 2021, ILD-ja ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesë padisë. Nga ana e KLP-së është ushtruar e drejta e rekursit pranë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda afateve ligjore. Për këtë rekurs, pritet ende një vendimmarrje nga ana e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë gjatë vitit 2023.
8. KLP-ja ka në fokus dhe për kompetencë ligjore zhvillimin e karrierës së prokurorëve, ku ndër të tjera, gjatë vitit 2022, ka kryer procedurën e ngritjes në detyrë për 2 (dy) prokurorë të SPAK. Gjatë konkurrimit, 3 (tre) kandidatë kanë shprehur interesin dhe kanë aplikuar për t’u ngritur në detyrë si prokuror të SPAK. Në përfundim të procedurës, KLP-ja emëroi dy prokurorë në SPAK prej 3 kandidatëve në garë, ndërsa kandidati i skualifikuar i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me ankim. Gjykata Administrative e Apelit vendosi rrëzimin e kërkesëpadisë. Pritet vendimi i arsyetuar i gjykatës gjatë vitit 2023.
9. Gjithashtu, gjatë vitit 2022, KLP-ja shpalli procedurën e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Për këtë pozicion shprehën interesin 3 (tre) kandidatë, ku njëri prej të cilëve është tërhequr më pas nga kandidimi. Në përfundim të procedurës, KLP-ja emëroi njërin prej kandidatëve në pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Kandidati tjetër, duke mos qenë dakord me vendimmarrjen e KLP-së, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit. Gjykata Administrative e Apelit vendosi rrëzimin e kërkesëpadisë. Pritet vendimi i arsyetuar i gjykatës gjatë vitit 2023. KLP-ja ka qenë palë e paditur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në çështje gjyqësore, që lidhen me detyrimin për pagesë kalimtare, të prokurorëve të

larguar nga sistemi, me atë të dorëheqjes, ose për shkak të shkarkimit nga organet Vetting, si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar. Këto padi janë shtuar gjatë vitit 2022 dhe pritet të shtohen edhe gjatë vitit 2023. Për këto kërkesëpadi, KLP-ja ka pretenduar se nuk është në pozitën e palës së paditur, pasi neni 149/a, pika 1, germa d), e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 159, pika 2, germa d), e Ligjit për Qeverisjen, përcaktojnë se, KLP-ja propozon dhe administron vetëm buxhetin e tij. Ndërkohë që, neni 38, pika 1, dhe 2/ç, si dhe nenit 40, të Ligjit për Prokurorinë, përcakton se, Prokurori i Përgjithshëm propozon dhe administron buxhetin e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe trajton financiarisht prokurorët e Republikës së Shqipërisë. Sa i përket rasteve të ish-anëtarëve të KLP-së, vetëm 2 (dy) prej tyre i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt “Dhënien e pagesës kalimtare”, vendimmarrja e së cilës pritet të jetë gjatë vitit 2023.

## **G. Veprimtaria e komisioneve të përhershme dhe komisioneve të tjera të Këshillit**

### **Komisionet e Përhershme**

#### **18. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit**

Komisioni i Buxhetit përbëhet nga:

- Zoti Tartar Bazaj i cili është edhe kryetar i këtij komisioni;
- Zonja Arta Mandro, anëtare e këtij komisioni që nga tetori i vitit 2022, e cila ka zëvendësuar ish-anëtarin e KLP-së, zotin Sandër Beci;
- Zoti Sokol Stojani.

Bazuar në nenin 160, pika 3/a, të Ligjit për Qeverisjen, Komisioni i Buxhetit ka propozuar marrjen e vendimeve në lidhje me buxhetin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore si për vitin 2022, ashtu edhe në kuadrin e përgatitjes së projektbuxhetit afatmesëm 2023-2025.

Komisioni gjatë vitit 2022 ka propozuar marrjen e vendimeve në lidhje me:

##### **a. Miratimin e kërkesave buxhetore për vitin 2023-2025**

Komisioni i Buxhetit, me mbështetjen e administratës ndërmori punën për përgatitjen e buxhetit të vitit 2023-2025, në zbatim të ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 (të ndryshuar), Udhëzimit Nr.7, datë 28.02. 2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, të Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave Nr.9, datë 08.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, si dhe të VKM-së Nr.130, datë 02.03.2022 “Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025”, është përgatitur dhe Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm të KLP-së, për periudhën 2023-2025. Ky plan i është dërguar Ministrisë së Financave, me shkresën Nr. 549/1 Prot, datë 06.05.2022.

KLP-ja, në mbledhjen plenare të datës 09.05.2022, me vendimin Nr. 96, ka miratuar relacionin e Komisionit të Buxhetit mbi kërkesat e PBA 2023-2025.

Për sa më sipër, nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë nuk janë marrë në konsideratë kërkesat për ndryshime, pasi në miratimin e taveve me VKM-së Nr.535, datë 29.07.2022, për “Miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025” buxheti reflekton tavane më të vogla nga ato të propozuara.

KLP-ja, në datën 02.11.2022, ka parashtruar përpara Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, kërkesat buxhetore për PBA, për periudhën 2023-2025, duke kërkuar ndër të tjera rritjen e numrit të personelit në 78 punonjës.

Për sa më sipër, kërkesat për shpenzimet buxhetore të PBA për vitet 2023-2025 janë pranuar pjesërisht nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, duke miratuar organikën prej 72 punonjës për KLP-në.

Për KLP-në, për vitin 2023 fondi i pagave (600) është 117,076,000 lekë dhe fondi për kontributet e sigurimeve shoqërore (601) është 15,441,000 lekë.

#### **b. Miratimin e kërkesave për lejimin e veprimtarive jashtë funksionit për prokurorët**

Si veprimtari funksionale e Komisionit të Buxhetit do të përmendim vendimet në lidhje me miratimin e veprimtarive jashtë funksionit për prokurorët, të cilat trajtohen nga ky Komision. Për vitin 2022, janë miratuar gjithsej 11 vendime, ku vlen të theksohet se në asnjë rast Komisioni i Buxhetit, por edhe Këshilli me vendimmarrjen e tij, nuk ka refuzuar asnjë prej tyre, pasi këto veprimtari në shumicën e tyre lidhen me mësimdhënie në Universitete Publike dhe Jopublike, e cila përbën një aspekt mjaft të rëndësishëm të zhvillimit dhe rritjes së cilësisë së të drejtës në përgjithësi.

Sa i takon sfidave apo pritshmërive për vitin 2023, vëmendje të veçantë merr plotësimi i diferencave buxhetore, në zërat e buxhetit që lidhen me pagat dhe sigurimet shoqërore, për shkak të efekteve të pritshme që rrjedhin nga zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.35, datë 22.11.2022. Sikurse u tha më sipër KLP-ja nuk gjeneron të ardhura të tjera përveç atyre që akordohen nga buxheti i shtetit.

### **19. Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale**

Bazuar në nenin 189 të Ligjit për Qeverisjen, parashikohet se ndër aktet që nxjerr KLP-ja, në ushtrim të funksioneve të tij, janë edhe aktet normative nënligjore, në zbatim të këtij ligji ose të ligjeve të tjera, me efekt të përgjithshëm detyrues mbi të gjithë prokurorët, administratën e prokurorisë, personat privatë dhe organet publike.

Në respektim të këtij parashikimi ligjor, pas një pune me kohëzgjatje 1 (një) vjeçare, me propozimin e grupit të punës të ngritur nga Kryetari, me urdhrin Nr. 51, datë 19.02.2021, KLP-ja me vendimin Nr.95, datë 29.05.2022, miratoi Rregulloren “Për Vlerësimin etik dhe profesional të Prokurorëve”. Kjo rregullore, si pjesë plotësuese të saj ka anekset, dhe formularët e integruar të vlerësimit, të cilat ndihmojnë kryerjen e këtij procesi dhe zbatohet për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të cilët kanë ushtruar detyrën e prokurorit gjatë periudhës së vlerësimit.

Konkretisht, Anekset Nr.1, Nr.2, Nr.3, Nr.4, Nr.5 dhe Nr.6, bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë të vlefshme vetëm për prokurorët, të cilët gjatë periudhës së vlerësimit kanë ushtruar funksionet në zyrat e Prokurorisë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë.

Në mbledhjen e datës 21.11.2022, KLP-ja miratoi Rregulloren “Për Vlerësimin Etik dhe Profesional për prokurorët e komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”.

Ndërsa, me vendimin Nr.312, datë 30.11.2022, KLP-ja miratoi një shtesë në Rregulloren për Vlerësimin, anekset 7 deri 11, për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve në Prokuroritë e Apelit.

Së afërmi pritet të miratohet edhe Rregulloja për vlerësimin e drejtuesve të prokurorive, për të cilët mbartet detyrimi ligjor për vlerësimin e tyre të paktën një herë gjatë kohëzgjatjes së mandatit si kryetar, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 84 të Ligjit Për Statusin.

Viti 2022 ka qenë një vit intensiv pune për Komisionin e Vlerësimit, në drejtim të fillimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve, si një nga detyrat kryesore të veprimtarisë së tij, bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës.

Qëllimi i këtij vlerësimi është përmirësimi i vazhdueshëm i etikës dhe aftësive profesionale të prokurorit, zhvillimi i karrierës mbi bazën e meritës, identifikimi më mirë i nevojave për kualifikimin e mëtejshëm, si dhe përmirësimi i efencës së zyrave të prokurorisë.

Referuar nenit 70, pika 1, të Ligjit për Statusin, të gjithë magjistratët, përfshirë dhe drejtuesit e prokurorive, janë subjekt i vlerësimit të tyre etik dhe profesional. Në bazë të nenit 174, të Ligjit për Statusin, KLP-ja miraton rregulla të detajuara për vlerësimin e magjistratëve në skemën e delegimit ose të komanduar.

Me vendimin Nr.95, datë 29.05.2022, KLP-ja miratoi Rregulloren “Për Vlerësimin etik dhe profesional të Prokurorëve”. Kjo rregullore, si pjesë plotësuese të saj ka anekset, dhe formularët e integruar të vlerësimit, të cilat ndihmojnë kryerjen e këtij procesi dhe zbatohet për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të cilët kanë ushtruar detyrën e prokurorit gjatë periudhës së vlerësimit.

Këto rregulla nuk zbatohen për vlerësimin etik dhe profesional të drejtuesit të prokurorisë, për veprimtarinë si drejtues, të anëtarit prokuror të KLP-së, për kohën që ai ushtron këtë funksion, për prokurorët në skemën e delegimit ose të komanduar në KLP, ose Prokurorinë e Përgjithshme. Rregullat që plotësojnë skemën e vlerësimit etik dhe profesional të këtyre subjekteve do të miratohen me rregullore të veçantë të KLP-së.

Bazuar në nenin 85, të Ligjit për Statusin, në të cilin parashikohet se, KLP-ja miraton programin që përcakton listën e magjistratëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi përgjatë vitit përkatës dhe periudhën e vlerësimit, KLP-ja, me vendimin Nr.140, datë 06.06.2002 ka miratuar “Programin që përcakton listën e prokurorëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional përgjatë vitit 2022 si dhe planifikimin tremujor të vlerësimeve individuale”.

Ky program materializohet nëpërmjet identifikimit dhe listimit të të gjithë atyre prokurorëve për të cilët mbartet detyrimi i kryerjes së vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2022, periudhën e vlerësimit dhe, për aq sa është e mundur, planifikimin tremujor të vlerësimeve individuale, duke garantuar një organizim efikas të procedurave të vlerësimit. Duke marrë në konsideratë faktin se, procesi i vlerësimit do të zhvillohej për herë të parë dhe në të u përfshinë një numër relativisht i madh të prokurorëve aktiv në sistem, ky proces u quajt projekt pilot, pasi u realizua pas 3 (tre) vjetësh të funksionimit të KLP-së si institucion dhe nuk mund të parashikohej se si do të vijonte ecuria e tij në praktikë.

Nga Komisioni u vlerësua si prioritet parësor në këtë proces, vlerësimi i magjistratëve prokurorë, të cilët kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar me një vendim të formës së prerë, me qëllim garantimin e zhvillimit të karrierës dhe përmirësimin e vazhdueshëm të etikës dhe aftësive profesionale të prokurorëve.

Në hartimin e listës së prokurorëve për t'u vlerësuar është mbajtur në konsideratë neni 84, i Ligjit për Statusin, lidhur me periudhën individuale të vlerësimit, specifikisht:

Magjistrati prokuror vlerësohet një herë në tre vjet, gjatë 15 viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmësmagjistrat ose magjistrat i

komanduar; Magjistrati prokuror vlerësohet një herë në pesë vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat.

Në këtë program vlerësimi, në bazë të parashikimeve të nenit 3 të Rregullores për Vlerësimin, nuk u përfshinë në procesin e vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2022, kategoritë e subjekteve si më poshtë: prokurorë të pezulluar, anëtarë prokurorë të KLP-së, për kohën që ushtrojnë këtë funksion; magjistratët e rinj të cilët nuk kanë ende 3 vjet eksperiencë pune (në total rezultuan 19 prokurorë); drejtuesit e prokurorive për veprimtarinë si drejtues.

Duke pasur si referencë vitin 2016, vit kur është bërë vlerësimi i fundit për prokurorët, Komisioni vendosi të kryejë procedurën e vlerësimit të magjistratëve prokurorë për herë të parë gjatë vitit 2022 dhe periudha e vlerësimit u përcaktua, nga data 1 Janar 2017 deri më datë 31 Dhjetor 2019 për vlerësimin 3-vjeçar dhe nga data 1 Janar 2017 deri më datë 31 Dhjetor 2021 për vlerësimin 5-vjeçar, në varësi të vjetërsisë në punë të magjistratit, për të gjithë ata prokurorë që sipas nenit 6, pika 4, të Rregullores për Vlerësimin, kanë ushtruar të paktën një vit funksionin e prokurorit në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, gjatë periudhës së vlerësimit.

Sa më sipër, Komisioni ka detyrimin ligjor për të kryer vlerësimin etik dhe profesional për 173 prokurorë në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë.

Me vendimin Nr.140, datë 06.06.2022 me propozimin e Komisionit të Vlerësimit, KLP-ja vendosi miratimin e *“Programit që përcakton listën e prokurorëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional përgjatë vitit 2022”*.

Duke pasur parasysh kapacitetet reale të Këshillit, kompleksitetin procedural, qëllimin e vlerësimit dhe ekonominë administrative, Komisioni i Vlerësimit vlerësoi aplikimin e disa filtrave selektivë me qëllim përcaktimin e listës së prokurorëve për të cilët mund të realizohet një proces vlerësimi i plotë dhe cilësor gjatë këtij viti. Mbi bazë të këtij arsytimi, në planifikimin tremujor të vlerësimeve individuale, referuar parashikimeve të nenit 16 të Rregullores, Komisioni vlerësoi të përfshijë në listën prioritare vetëm ata prokurorë, të cilët kanë kaluar procesin e vettingut me vendim të formës së prerë. Gjithashtu, Komisioni vlerësoi të mos përfshijë në këtë listë prokurorët që mund të jenë në prag pensioni, si dhe prokurorët e SPAK-ut, për arsye se vlerësimi i këtyre të fundit në këtë moment nuk ka prioritet pasi nuk do të sillte pasoja në zhvillimin e karrierës së tyre duke pasur në konsideratë mandatin e tyre 9-vjeçar.

Me vendimin Nr.141, datë 06.06.2022, me propozimin e Komisionit të Vlerësimit, KLP-ja vendosi miratimin e *“Planifikimit tremujor të vlerësimeve etike dhe profesionale të prokurorëve, përgjatë vitit 2022”*.

Nisur nga fakti që procesi i vlerësimit po zhvillohet për herë të parë dhe duke pasur për qëllim kryerjen një procedurë transparente të subjekteve që u përfshinë në këtë proces, Komisioni i Vlerësimit propozoi që procedura e shortimit për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve gjatë vitit 2022 të hidhet për 10 (dhjetë) prokurorë, konkretisht nga 5 (pesë) prokurorë për secilën nga periudhat e vlerësimit.

Me vendimin Nr.142, datë 06.06.2022, me propozimin e Komisionit të Vlerësimit, KLP-ja vendosi *“Caktimin me short të Relatorit dhe Këshilltarit ligjor përgjegjës për procedurën e vlerësimit të prokurorëve”*.

Relatori, në bazë të Rregullores për Vlerësimin është anëtar i Komisionit të Vlerësimit në Këshill dhe/ose anëtar i zëvendësues, i caktuar me short për çdo vlerësim, i cili kujdeset për zhvillimin e procesit administrativ individual, sa i takon shqyrtimit të dokumentacionit të

depozituar nga subjektet e procedurës administrative, përgatitjes së projektaktit administrativ, koordinimit me kryetarin e komisionit për përgatitjen e mbledhjes së komisionit etj.

Këshilltari për vlerësimin është prokurori i komanduar pranë Këshillit, pjesë e njësisë mbështetëse të komisioneve, i cili është përgjegjës, për mbledhjen e dokumentacionit dhe krijimin e dosjes së vlerësimit, hartimin e raportit analitik; si dhe çdo detyrë tjetër të caktuar në ligj dhe në Rregulloren për Vlerësimin.

Aktualisht, vlerësimi i 10 (dhjetë) prokurorëve të shortuar është në proces pasi gjatë këtij procesi janë hasur vështirësi në plotësimin e tabelave sipas anekseve të Rregullores nga prokuroritë, në të cilat kanë ushtruar funksionin prokurorët e shortuar për vlerësim. Ky ngërç ka sjellë dhe vonesë në kryerjen në afat të këtij procesi.

Konkretisht, Aneksi Nr.1 i Rregullores, *“Metodologjia e pikëzimit”*, ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të prokurorit, për secilin kriter, dhe treguesit përkatës ligjorë, mbi bazën e një sistemi pikësh, të përcaktuar mbi meritat e prokurorit, kualifikimin, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin e tij, duke respektuar parimin e pavarësisë së prokurorit. Aneksi Nr.2 i Rregullores ka miratuar modelin e tabelave statistikore me të dhënat për secilin prokuror që do të vlerësohet si dhe të dhënat mesatare për seksionet apo të gjithë Prokurorinë ku ka ushtruar detyrën prokurori i cili vlerësohet. Plotësimi i tabelave statistikore të miratuara në Aneksin Nr.2, sipas përcaktimeve të Ligjit për Statusin dhe *“Rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”*, miratuar me vendimin Nr.95, datë 09.05.2022 të KLP-së, ka hasur vështirësi teknike për shkak të integritetit të disa të dhënave referuese të cilat nuk ishin parashikuar më parë në regjistrat fizikë dhe elektronikë që plotësonin Prokuroritë për efekt statistikash. Plotësimi i një pjesë të dhënave statistikore në rrugë manuale ka sjellë vonesa në ecurinë e hedhjes së shortit të dosjeve që do të vlerësohen si pjesë e procesit të mëtejshëm. Në takimet e zhvilluara me Prokurorin e Përgjithshëm është trajtuar problematika e hasur dhe mundësia e bashkëpunimit në plotësimin e regjistrave fizikë statistikore me të dhënat që kërkohen për procesin e vlerësimit etiko-profesional të prokurorëve, si dhe nevojën e krijimit të një sistemi të unifikuar elektronik të të dhënave statistikore.

Për kryerjen e vlerësimit të magjistratit prokuror nevojiten të dhëna statistikore nga prokuroria ku magjistrati që vlerësohet ka ushtruar detyrën.

Bazuar në nenin 171, pika 8 të Ligjit për Statusin përcaktohet se: *“Të dhënat statistikore përpunohen nga gjykata ose prokuroria ku ushtron detyrën magjistrati që do të vlerësohet, si dhe dërgohen nga kryetari të Këshilli përkatës, deri në momentin që Këshillat kanë akses të drejtpërdrejtë në të dhënat e sakta dhe të sigurta statistikore në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve në gjykata dhe në prokurori. Të dhënat statistikore për magjistratin që është në proces vlerësimi i dërgohen Këshillit respektiv nga kryetari i gjykatës ose i prokurorisë, në të cilën magjistrati ka ushtruar detyrën gjatë periudhës për të cilën kryhet vlerësimi. Këshilli përcakton me vendim kohën dhe procedurat e marrjes drejtpërdrejt të të dhënave statistikore nga sistemi”*.

Në përmbushje të detyrimit ligjor që sanksionon ligji në këtë dispozitë kalimtare, që KLGJ-ja dhe KLP-ja në momentin kur vlerësojnë magjistratin aksesojnë programet statistikore, sugjerojmë si rrugëzgjdhje të domosdoshme dhe imediate një program statistikor për sistemin e prokurorisë të ngjashëm me atë të sistemit gjyqësor, pasi dhe ligji për Statusin identifikon të njejtët tregues vlerësimi.

Bazuar në nenin 85 të Ligjit për Statusin, parashikohet se, Këshilli, jo më vonë se muaji Nëntor i çdo viti, miraton programin që përcakton listën e magjistratëve dhe kryetarëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi përgjatë vitit përkatës dhe periudhën e vlerësimit. Në program përfshihen të paktën ata magjistratë, për të cilët përfundon ose ka përfunduar periudha e



vlerësimin në vitin pasardhës, me qëllim që të sigurohet në kohë vlerësimi etik dhe profesional i magistratit.

Në respektim të këtij detyrimi ligjor, Komisioni i Vlerësimit, me relacionin Nr. 2346 Prot., datë 25.11.2022, i propozoi Këshillit të Lartë të Prokurorisë të miratojë programin që përcakton listën e prokurorëve për të cilët do të kryhet procesi i vlerësimit etik dhe profesional përgjatë vitit 2023, sipas listës bashkëlidhur të përpiluar nga Sektori i Burimeve Njerëzore pranë KLP-së, e cila përmbante prokurorët aktivë të shkallës së parë, apelit, SPAK-ut dhe Prokurorinë e Përgjithshme. Në këtë listë ishin përfshirë edhe prokurorët e emëruar nga Prokuroria e Shkallës së Parë në Prokuroritë e Apelit, SPAK-ut, si dhe të komanduarit (ILD, MD, KLP, PP etj), shoqëruar me vjetërsinë respektive në punë të këtyre magistratëve. Referuar parashikimeve të nenit 16 të Rregullores për Vlerësimin, Komisioni vlerësoi të përfshijë në aneksin Nr.1 (lista e madhe bashkëlidhur programit të vlerësimit) të gjithë prokurorët aktivë në sistem me mbi 3 vite përvojë pune.

Në mbledhjen e datës 30.11.2022, KLP-ja pasi u njoh me relacionin e paraqitur nga komisioni, me vendimin Nr.313, datë 30.11.2022, vendosi të miratojë programin që përcakton listën e prokurorëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional individual përgjatë vitit 2023, sipas listës bashkëlidhur, me kriteret seleksionuese si më poshtë:

- Mospërfshirjen në këtë listë të prokurorëve që mbushin moshën për pension pleqërie, brenda 5 viteve të fundit.
- Mospërfshirjen në këtë listë të Prokurorit të Përgjithshëm dhe prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme.
- Përfshirjen në këtë listë të prokurorëve që nuk kanë vlerësim ose që kanë të paktën një vlerësim etik dhe profesional.

Ky vlerësim etik dhe profesional i vitit 2023 do të zbatohet vetëm për ata magistratë për të cilët KLP-ja ka miratuar rregullore vlerësimi.

Komisioni i Vlerësimit vendosi të vlerësojë prokurorët e përzgjedhur për t'u vlerësuar përgjatë vitit 2023 për periudhën kohore të vlerësimit nga data 1 Janar 2017 deri më datë 31 Dhjetor 2019 për vlerësimin 3-vjeçar dhe nga data 1 Janar 2017 deri më datë 31 Dhjetor 2021 për vlerësimin 5-vjeçar, në varësi të vjetërsisë në punë të magistratit, për të gjithë ata prokurorë që sipas nenit 6, pika 4, të Rregullores për Vlerësimin, kanë ushtruar të paktën një vit funksionin e prokurorit në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, gjatë periudhës së vlerësimit.

Me qëllim përcaktimin e listës së prokurorëve për të cilët mund të realizohet një proces vlerësimi i plotë dhe cilësor gjatë këtij viti, Komisioni i Vlerësimit, vlerësoi aplikimin e disa filtrave efektivë.

Mbi bazë të këtij arsytimi, në planifikimin tremujor të vlerësimeve individuale, sipas parashikimeve të nenit 3 të Rregullores për Vlerësimin, nuk përfshihen në programin e vlerësimit përgjatë vitit 2023 drejtuesit për veprimtarinë si drejtues, magistratët e rinj të cilët nuk kanë plotësuar ende 3 vite përvojë pune në sistem, si dhe anëtarët prokurorë të KLP-së, për kohën që ushtrojnë këtë funksion.

Komisioni i Vlerësimit vendosi të mos përfshijë në program 10 (dhjetë) prokurorët, të cilët janë shortuar për t'u vlerësuar përgjatë vitit 2022, në Qershor të këtij viti dhe janë ende në proces vlerësimi.

Duke marrë në konsideratë kapacitetet reale të Këshillit, ngarkesën në punë të këshilltarëve prokurorë të komanduar të cilët njëkohësisht përgatisin raportet e vlerësimit të aftësive

profesionale në kuadër të procesit të vettingut, si dhe nisur nga fakti që procesi i vlerësimit ka filluar për 10 (dhjetë) prokurorë, KLP-ja, me propozim të Komisionit të Vlerësimit miratoi vendimin Nr.316, datë 02.12.2022, “Për planifikimin tremujor të vlerësimit etik dhe profesional individual të 20 (njëzet) prokurorëve përgjatë vitit 2023”.

Në zbatim të këtij vendimi, procedura e shortimit e parashikuar nga neni 161 i Ligjit për Qeverisjen, dhe neni 17 i Rregullores për Vlerësimin u zhvillua për 20 prokurorë.

Bazuar në listën e prokurorëve që i nënshtrohen vlerësimit, sipas programit të miratuar në mbledhje plenare, Këshilli caktoi me short relatorin dhe këshilltarin përgjegjës për çdo vlerësim, duke mbajtur parasysh, për aq sa është e mundur, barazinë e shpërndarjes së punës.

Konkretisht, me vendimin Nr.317, datë 02.12.2022 “Për caktimin me short të relatorit dhe këshilltarit ligjor përgjegjës për procedurën e vlerësimit të prokurorëve”, KLP-ja miratoi shortimin për 20 (njëzet) prokurorë nga të cilët: 7 (shtatë) prokurorë që rezultojnë pa dhe me një vlerësim të cilët kaluan automatikisht për vlerësim dhe për 13 (trembëdhjetë) prokurorët e tjerë, ky proces u krye duke pasur parasysh një mesatare të ponderuar në raport me numrin e prokurorëve në prokuroritë e secilit juridiksion. Metodologjia e mesatares së ponderuar, u aplikua për herë të parë në këtë proces, për të mundësuar një shortim transparent, të barabartë dhe të paanshëm për të gjithë prokurorët.

#### **a. Raporte të vlerësimit të aftësive profesionale të prokurorëve**

Komisioni i Vlerësimit, bazuar në nenin 160, pika 2, germa “d”, të Ligjit për Statusin, kryen vlerësimin e punës, siç parashikohet në dispozitën kalimtare të këtij ligji, duke përfshirë edhe ndihmën në rivlerësimin kalimtar të prokurorëve, në bazë të Ligjit për Rivlerësimin, duke kontribuar në përgatitjen e Raporteve individuale të Prokurorëve.

Në përgatitjen e raporteve për analizimin e aftësive profesionale të prokurorëve të subjekteve të rivlerësimit kalimtar, Komisioni është ndihmuar nga 5 (pesë) prokurorë të sistemit të prokurorisë, të cilët janë komanduar të punojnë pranë KLP-së edhe për një periudhë tre-vjeçare me vendimet Nr. 66-71, datë 24.02.2020, të KLP-së.

Këto raporte janë hartuar duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara në bashkëpunim me KPK-në si, aftësitë profesionale, aftësitë organizative, etika dhe angazhimi në veprimtari profesionale, dhe duke u bazuar në gjetjet në aktet e administruara, për analizimin e aftësive profesionale. Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me KPK kanë përcaktuar modelin mbi bazën e të cilit duhet të hartohet raporti i vlerësimit të aftësive profesionale në kuadër të procesit të rivlerësimit.

Në të gjitha rastet, kur janë konstatuar gjetje, ato janë evidentuar në pjesën e raportit që analizon dokumentet ose dosjet. Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale në kuadër të procesit të rivlerësimit, konkludon nëse subjekti i rivlerësimit arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, standard i mjaftueshëm për konfirmimin në detyrë sipas nenit 59 të Ligjit Nr. 84 të vitit 2016.

Në asnjë rast, organet e vettingut nuk kanë adresuar në KLP, problematika mbi cilësinë e raporteve të aftësive profesionale, në kuadër të procesit të rivlerësimit.

Në përfundim, janë përgatitur dhe janë miratuar në seancë plenare nga KLP-ja, për gjatë vitit 2022 gjithsej 32 (tridhjetë e dy) Raporte për subjekte magjistratë (prokurorë), që janë vënë në dispozicion të KPK-së dhe ONM-së.

Verifikimi i pasurisë dhe figurës, për kandidatët që do të pranohen në Formimin Fillestar të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2022-2023

Në nenin 183, pika 1 të Ligjit për Qeverisjen parashikohet bashkëpunimi i KLP-së me Shkollën e Magjistraturës për rekrutimin e kandidatëve për prokurorë.

Bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit për Statusin parashikohet se: “Në Janar të çdo viti, Këshillat, pasi kanë kryer një analizë të nevojave, përcaktojnë dhe publikojnë numrin maksimal të kandidatëve magjistratë që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik”.

Në respektim të këtij detyrimi ligjor, KLP-ja miratoi vendimin Nr.19, datë 31.01.2022, me të cilin vendosi që numri maksimal i kandidatëve për magjistratë të profilit prokuror që do të pranoheshin në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës të jetë 35 (tridhjetë e pesë) kuota. Për vitin akademik 2022-2023 u pranuan sipas kuotave të Shkollës së Magjistraturës 29 (njëzet e nëntë) kandidatë për profilin prokuror.

Bazuar në nenin 32, të Ligjit për statusin, Komisioni i Vlerësimit kryen procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për t'u pranuar në Formimin Fillestar të Shkollës së Magjistraturës.

Në kuadër të këtij procesi, pas njoftimit të listës së kandidatëve me rezultatet më të larta nga Shkolla e Magjistraturës (më tej, SHM), me propozim të Komisionit, Këshilli ka miratuar vendimet si vijon:

- 1- Vendim Nr. 138, datë 02.06.2022 *“Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për t'u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023”.*
- 2- Vendim Nr. 139, datë 02.06.2022 *“Për bedhjen e shortit dhe caktimin e relatorit për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët për t'u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023”.*

Në zbatim të vendimeve të sipërcituara, KLP-ja ka filluar procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës për 29 (njëzet e nëntë) kandidatët për magjistratë dhe ka kërkuar informacion zyrtar nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues. Konkretisht, janë kërkuar informacione të detajuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më tej, ILDKPI), prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës të kandidatëve.

Komisioni ka kërkuar informacion shtesë nga institucionet përgjegjëse të sipërcituara rast pas rasti për ndonjë nga kandidatët që u verifikuan. Gjithashtu, për 1 (një kandidat) është zhvilluar edhe seancë dëgjimore për të sqaruar çështje të ndryshme si pjesë e këtij procesi.

Pas përfundimit të këtij procesi verifikimi, KLP-ja mori vendim për të konsideruar të përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës për 28 (njëzet e tetë) kandidatë për vitin akademik 2022-2023, sipas përcaktimeve të nenit 32, të Ligjit për Statusin,

Për 1 (një) kandidat, pas përfundimit të procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës është marrë vendim ndalimi nga ana e KLP-së. Ndërsa për 1 (një) kandidat procedura është akoma në proces.

Verifikimi i pasurisë dhe figurës për kandidatët për prokurorë të cilët përfundojnë formimin fillestar të shkollës së magjistraturës në vitin 2022

Bazuar në pikën 1, të nenit 148/ç, në pikën 1, të nenit 149 dhe në germën “a”, të nenit 149/a të Kushtetutës, në pikën 1, të nenit 159 dhe pikën 2, të nenit 190, të Ligjit për Qeverisjen, në

pikat 2-6, të nenit 32 dhe pikës 1, germa “c”, të nenit 35, të Ligjit për Statusin, si dhe në Rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, e ndryshuar, miratuar me Vendimin Nr.171, datë 27.09.2019, të KLP-së, Komisioni i Vlerësimit kryen verifikimin e pasurisë, figurës dhe integritetit si dhe kushteve të tjera ligjore të kandidatëve për t’u emëruar magjistratë Prokuror, pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës.

Për vitin 2022 ka pasur 22 (njëzetë e dy) kandidatë të diplomuar në profilin Prokuror nga SHM-ja. Me propozim të Komisionit, Këshilli ka miratuar vendimet si vijon:

1. Vendim Nr. 14, datë 24.01.2022 *“Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për magjistratë prokurorë, të cilët do të diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2022”.*
2. Vendim Nr. 15, datë 24.01.2022 *“Për hedhjen e shortit dhe caktimin e relatorit për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët për magjistratë prokurorë, të cilët do të diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2022”*

Bazuar në nenin 32, të Ligjit për Statusin, Komisioni i Vlerësimit ka filluar procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës për 22 (njëzetë e dy) kandidatët për magjistratë prokurorë, të cilët do të diplomohen nga SHM-ja në vitin 2022. Në vijim të kësaj procedure, Komisioni ka kërkuar informacion zyrtar nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues. Konkretisht, janë kërkuar informacione të detajuara nga ILDKPI-ja, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës të kandidatëve.

#### **b. Verifikimi i pasurisë dhe figurës për kandidatët për pozicion drejtuesi në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm**

Bazuar në nenin 47 dhe nenin 48, të Ligjit për Statusin, magjistrati mund të ngrihet në detyrë, në pozicionin e kryetarit të prokurorisë së shkallës së parë ose të dytë, nëse ka ushtruar funksionin e magjistratit jo më pak se shtatë vjet, gjatë të cilës, të paktën katër vjet në të njëjtën shkallë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar, përmbush treguesit e kërkuar për aftësi organizative dhe drejtuese, të tilla si, përvoja si zëvendëskryetar, kryetar i një seksioni ose magjistrat për çështjet e shtypit, përvoja në pozicione drejtuese në administratën publike ose të drejtësisë, ose përvoja si anëtar i Këshillit, që ka përfunduar të paktën në tre vjet më parë, njohuri për strukturat organizative dhe modele të ndryshme të drejtimit, si magjistrat në skemën e delegimit ose inspektor në Zyren e ILD-së, nuk ka qenë anëtar i Këshillit në tre vitet e fundit.

Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës dhe që nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë. Ky proces ishte risi dhe njëkohësisht sfidë e Komisionit të Vlerësimit, në përfundim të së cilës rezultoi se, vendimmarrjet e KLP-së ishin të njëjta me vendimmarrjet e institucioneve të Vetting-ut për të njëjtat subjekte kontrolli.

Komisioni hartoi vendimet përkatëse për fillimin e verifikimit të pasurisë dhe figurës dhe vendimet për caktimin e relatorëve për magjistratët aplikantë sipas pozicioneve të lira të shpallura nga Këshilli si vijon:

1. Vendim Nr. 16, datë 24.01.2022, “Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi, të shpallur me vendimin nr. 220, datë 29.06.2021, të KLP-së (Kavajë).
2. Vendimi Nr. 17, datë 24.01.2022, “Për caktimin me short të Relatorëve që do të kryejnë procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi, të shpallur me vendimin nr. 220, datë 24.01.2022, të KLP-së (Kavajë).
3. Vendim Nr. 136, datë 02.06.2022, “Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi, të shpallur me vendimin nr. 125, datë 26.05.2022, të KLP-së (Tiranë).
4. Vendimi Nr. 137, datë 02.06.2022, “Për caktimin me short të Relatorëve që do të kryejnë procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi, të shpallur me vendimin nr. 125, datë 26.05.2022, të KLP-së (Tiranë).
5. Vendim Nr. 164, datë 05.07.2022, “Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi, të shpallur me vendimin nr. 153, datë 27.06.2022, të KLP-së (Sarandë).
6. Vendimi Nr. 162, datë 05.07.2022, “Për caktimin me short të Relatorëve që do të kryejnë procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi, të shpallur me vendimin nr. 153, datë 27.06.2022, KLP-së (Sarandë).
7. Vendim Nr. 163, datë 05.07.2022, “Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi, të shpallur me vendimin Nr. 152, datë 27.06.2022, të KLP-së (Fier).
8. Vendimi Nr. 161, datë 05.07.2022, “Për caktimin me short të Relatorëve që do të kryejnë procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi, të shpallur me vendimin nr. 152, datë 27.06.2022, të KLP-së (Fier).

## **20. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës**

Referuar nenit 41 të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, fusha e veprimtarisë së Komisionit i Karrierës ka si objekt çdo çështje që kanë lidhje me:

- a. procedurën e emërimit të kandidatëve për prokurorë, si dhe të caktimit të të emëruarve në pozicionet e lira ose caktimit të përkohshëm të tyre në pozicione të komanduara;
- b. procedurat e transferimit të prokurorëve;
- c. procedurën e caktimit të përkohshëm të prokurorëve;
- d. procedurën e caktimit të prokurorëve në skemën e delegimit;
- e. procedurën e komandimit të prokurorit në një pozicion “joprokuror”, në një institucion brenda sistemit të drejtësisë;
- f. dh) procedurën e ngritjes në detyrë të prokurorëve;
- g. mbarimin e statusit të prokurorit;
- h. ë) trajtimin e kërkesave të prokurorëve, për ulje të ngarkesës së çështjeve;
- i. Hartimin dhe ndryshimin e akteve nënligjore, të cilat lidhen me fushën e veprimtarisë së Komisionit;
- j. procedurën e caktimit/komandimit të Këshilltarit të Etikës;
- k. të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj, në përputhje me fushën e veprimtarisë së këtij Komisioni.

Në mënyrë të përmbledhur, veprimtaria e këtij Komisioni paraqitet si më poshtë:

KLP, për periudhën 1 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022, në seanca plenare ka miratuar në total 333 akte administrative me karakter individual, kolektiv ose normativ, prej të cilave 181 akte janë propozuar nga Komisioni i Karrierës. Në aspektin sasior veprimtaria e komisionit ka ndikuar në rreth 55 % të akteve të miratuara nga KLP-ja.

**TABELA SASISORE E AKTEVE TË KOMISIONIT TË KARRIERËS**

<b>Lloj aktit</b>	<b>Sasia</b>
Për caktim të përkohshëm	<b>83</b>
Për mbarim statusi për shkak dorëheqje, pensioni	<b>5</b>
Për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës	<b>7</b>
Për transferim të përkohshëm me pëlqim	<b>4</b>
Për pranimin e kërkesës dhe miratimin e qëndrimit në detyrë të magjistratit	<b>4</b>
Për kualifikimin e kandidatëve që plotësojnë kushtet për kandidim për ngritjen në detyrë në pozicionin e drejtuesit në Prokurori	<b>3</b>
Për emërimin magjistratë	<b>22</b>
Për caktimin në detyrën e prokurorit	<b>22</b>
Për mbylljen e procedurës së ngritjes në detyrë të drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë	<b>2</b>
Për plotësimin e një vakance të përkohshme në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, nëpërmjet procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim	<b>2</b>
Për përcaktimin e numrit të kandidatëve për magjistratë profili prokuror në programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës	<b>1</b>
Për plotësimin e pozicionit të Këshilltarit për Etikën pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, përmes procedurës së komandimit	<b>1</b>
Për komandimin e prokurorit në pozicionin e Këshilltarit për Etikën pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë	<b>1</b>
Për ndalimin e kandidimit të kandidatit për ngritjen në detyrë në pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë	<b>1</b>
Për shpalljen e vendeve vakante për drejtues të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë	<b>1</b>
Për shpalljen e vendit vakant për drejtues në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar	<b>1</b>
Për caktimin e anëtarit për komunikimin me median	<b>1</b>
Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele	<b>1</b>
Për emërimin e drejtuesit në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar	<b>1</b>
Vendime të tjera	<b>18</b>
<b>Totali</b>	<b>181</b>

Gjatë vitit 2022, anëtarët dhe këshilltarët e këtij Komisioni kanë qenë të angazhuar në hartimin e ndryshimeve në Rregulloren për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

Në rastin e caktimeve të përkohshme, KLP-ja është treguar shumë i kujdesshëm në zbatimin e nenit 59, të Ligjit për Statusin, duke e zbatuar këtë dispozitë vetëm në ato raste kur caktimi i përkohshëm i një prokurori në cilësinë e Drejtuesit, apo të prokurorit të

juridiksionit të përgjithshëm apo në nivel apeli, ka qenë domosdoshmëri. Për rrjedhojë, Vendimet e KLP-së për caktimin e përkohshëm të prokurorëve kanë ardhur si rezultat i një vendimmarrje të KPK-së dhe krijimit të vendeve të lira përkohësisht për shkak të arsyeve të tjera të ndryshme.

Nga një analizë e gjendjes aktuale të burimeve të gjitha zyrave të prokurorive ku përfshihet Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroritë e Apelit dhe Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, rezultojnë si më poshtë:

Sikurse dihet organika totale e sistemit të prokurorisë së Republikës së Shqipërisë parashikon 341 prokurorë.

Statistikat e mësipërme paraqesin gjendjen e prokurorive përpara implementimit të hartës së re gjyqësore, pasi sikurse dihet aktualisht janë shkrirë prokuroritë e apeleve në rrethe duke u përthithur nga prokuroria e juridiksionit të përgjithshëm me seli në Tiranë.

Përveç vakancave në sistem të cilat janë evidente vihet re se nga 30 zyra të Prokurorive të Apeleve dhe pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, SPAK-ut dhe Prokurorisë së Përgjithshme, në fund të vitit 2022 rezultojnë se:

- a. 13 prokurorë janë të caktuar përkohësisht si drejtues; përkatësisht 10 drejtues në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe 3 drejtues në Prokuroritë pranë Gjykatave të Apelit. Me shkrirjen e prokurorive të apelit ngelen 10 drejtues të caktuar përkohësisht në prokuroritë e shkallëve të para, situatë e cila pritet të ndryshojë në vijim, për shkak të procedurave në proces për ngritjen në detyrën e drejtuesit si dhe për shkak të implementimit të hartës së re gjyqësore në nivel të shkallëve së parë.
- b. 5 prokurorë janë caktuar përkohësisht nga Shkalla e Parë në Apel, kurse një prej tyre është nga një Prokurori pranë Gjykatës së Shkallës së Parë në një tjetër Prokurori pranë Gjykatës së Shkallës së Parë;
- c. 2 prokurorë rezultojnë të caktuar përkohësisht nga Prokuroria e Përgjithshme në një prokurori të shkallës së parë.

Në vlerësim të të dhënave të mësipërme në këtë aspekt Komisioni, për rrjedhojë edhe KLP-ja, ka përballuar mjaftueshëm mirë situatën sa i takon problematikave të shkaktuara nga vakancat e shumta në sistem, duke garantuar funksionalitetin e secilës zyre prokurorie të sistemit.

Nga ana tjetër, për plotësimin në mënyrë permanente të vakancave të krijuara në sistem kanë shërbyer emërimet magjistrat dhe caktimet në detyrë të 22 studentëve të diplomuar në vitin 2022, nga SHM-ja. Vlen të theksohet se ky proces u realizua me dakordësinë e vetë studentëve pa qenë nevoja e konkurrimit apo përzgjedhjes së tyre nga ana e Këshillit.

Përveç prurjeve të reja nga SHM-ja për vitin 2022, sikurse dihet nga ana e Këshillit janë bërë disa propozime për ndryshime ligjore, ku ai që lidhet drejt për drejt me këtë çështje ishte edhe përfshirja në sistem e studentëve pas përfundimit të vitit të dytë akademik në Shkollën e Magjistraturës, për një periudhë kalimtare, me qëllim normalizimin dhe balancimin e efekteve të procesit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve. Aktualisht ky propozim nuk është materializuar ende.

Nga ana tjetër në kuadër të përcaktimit të kuotave që lidhen me numrin e kandidatëve për prokuror në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, Këshilli me propozim të Komisionit të Karrierës u propozuan 40 kandidatë, pra një shtesë prej 15 kandidatësh në raport me një vit më parë.

Gjithashtu për nga rëndësia, duhet të evidentohet zgjedhja e drejtuesit të ri të SPAK-ut, proces si çili u zhvillua i hapur duke i dhënë mundësi të gjithë prokurorëve të kësaj strukture të kandidonin. Në këtë garë morën pjesë tre kandidatë dhe përzgjedhja e drejtuesit të ri u bë në mënyrë transparente.

Në vijim të vëmendjes së veçantë që Komisioni dhe Këshilli ka pasur për strukturën e SPAK-ut dhe bazuar në detyrimin për plotësimin e 3 vakancave të kësaj strukture, aktualisht nga ana e grupit të punës është përgatitur drafti për rregulloren e zgjedhjes së prokurorëve të kësaj prokurorie, e cila pritet të diskutohet në Këshill dhe me grupet e interesit në ditët në vijim.

Një tjetër moment për tu përmendur është edhe zgjedhja e Këshilltarit të Etikës, nëpërmjet procedurës së komandimit, vendim i çili plotësoi një vakancë disa vjeçare në organikën e KLP-së.

## **21. Komisioni i Disiplinor**

Objekti kryesor i punës së Komisionit Disiplinor është zhvillimi i procedurave disiplinore të filluara nga ILD-ja ndaj magistratëve prokurorë në zyra apo nivele të ndryshme të sistemit të prokurorisë.

Komisioni Disiplinor, me administrimin e kërkesës për fillimin të procedimit disiplinor, të raportit të hetimit si dhe dosjes hetimore, të paraqitura nga ILD-ja fillon menjëherë procedurën disiplinore ndaj një magistrati prokuror. Puna e këtij Komisioni është e ndërvarur me kërkesat për fillim të procedimit disiplinor të ILD-së.

Gjatë vitit 2022, Komisioni Disiplinor ka zhvilluar disa procedura disiplinore ndaj prokurorëve, me funksione të ndryshme në hierarkinë e sistemit të prokurorisë.

### **a. Procedime disiplinore ndaj prokurorëve**

Gjatë vitit 2022, Komisioni Disiplinor ka përfunduar 2 (dy) procedura disiplinore, për prokurorët si vijon:

#### **i. B.Z., Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër**

Pasi ka shqyrtuar Kërkesën “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistratit B.Z., me detyrë prokurorë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër”, të ILD-së, në përfundim të procedimit disiplinor, me Vendimin Nr.20, datë 31.01.2022, KLP-ja ka vendosur: Pranimin e kërkesës Nr. 2346 prot., datë 29.10.2021 të paraqitur nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për procedim disiplinor ndaj prokurores B.Z. Dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga Detyra” për magistraten B.Z.

#### **ii. F. G., dhe M. L., Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë dhe Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**

Pasi ka shqyrtuar Kërkesën “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistratit F.G., me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe magistratit M.L., me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me Vendimin Nr.31, datë 24.02.2022, KLP-ja ka vendosur: Rrëzimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj magistratit F.G. Rrëzimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj magistratit M.L. Vendimi i mësipërm i KLP-së për rrëzimin e kërkesës për caktimin e kësaj mase disiplinore nuk është marrë në unanimitet të



plotë dhe është shoqëruar me mendime të pakicës së disa nga anëtarët e këshillit. Zhvillimi i procedurave të mësipërme disiplinore ka konsoliduar më tej praktikën ekzistuese të këshillit, për sa i takon realizimit të procedurave disiplinore ndaj magjistratëve.

## **b. Procedura disiplinore në proces**

Gjatë vitit 2022, KLP-ja ka shqyrtuar 2 (dy) kërkesa të tjera për fillimin e procedimit disiplinor ndaj dy magjistratëve prokurorë, të ardhura nga ILD-ja, kërkesa për të cilat ka vendosur pezullimin e procedimit deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj tyre.

### **i. Procedimi disiplinor ndaj magjistratit E.R**

ILD-ja ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit E.R., me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, dhe caktimin e masës disiplinore “*Shkarkim nga detyra*”.

Me Vendimin Nr.307, datë 21.11.2022, KLP-ja ka vendosur pezullimin e procedimit disiplinor nr. 100/43, datë 21.10.2022, të filluar me kërkesë të ILD-së ndaj prokurorit E.R., deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit.

### **ii. Procedimi disiplinor ndaj magjistratit E.K**

ILD-ja ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit E.K., me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe caktimin e masës disiplinore “*Vërejtje publike*”.

Me Vendimin Nr.333, datë 19.12.2022, KLP-ja ka vendosur pezullimin e procedimit disiplinor nr. 251/31, datë 21.07.2020, të filluar me kërkesë të ILD-së ndaj prokurorit E.K., deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit.

Rezulton se, 2 (dy) magjistratët e mësipërm kanë cilësinë e subjektit në procesit e rivlerësimit kalimtar që po zhvillohet sipas Ligjit për Rivlerësimin dhe, ndaj tyre, KPK-ja ka vendosur masën disiplinore “*Shkarkim nga detyra*”. Subjektet/magjistratët e mësipërm kanë paraqitur ankim në KPA dhe ku pritet shqyrtimi i ankimeve.

Në përputhje me Pikën 6, të Nenit F, të Aneksit “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, të Kushtetutës, aktualisht, dy magjistratët e shkarkuar janë të pezulluar nga detyra.

Njëkohësisht me procesin e rivlerësimit kalimtar, magjistratët e mësipërm janë hetuar për shkelje disiplinore sipas Ligjit për Statusin, në përfundim të të cilit ILD-ja ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor dhe caktimi i masave disiplinore, si më sipër.

Në Nenin 179/b, pika 7, të Kushtetutës dhe në nenin 164, të Ligjit për Statusin, parashikohet se, moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit kalimtar përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës. Prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit vetëm nëse kalojnë me sukses këtë proces, në përputhje me Ligjin për Rivlerësimin. Për rrjedhojë, këto procedura disiplinore kanë ndikim tek njëra-tjetra duke përcaktuar vijueshmërinë e tyre.

Procesi i rivlerësimit kalimtar, si një masë e jashtëzakonshme nuk është një rrethanë apo situatë, pjesë e rregullimeve të përhershme në Ligjin për Statusin, për shkak të përkozhshmërisë së zbatimit të këtij procesi. Ndërkohë, në kuptim dhe zbatim të ligjit për Statusin, magjistrati nuk mund të jetë në të njëjtën kohë nën disa hetime ose procedime disiplinore të veçanta.

Në kushtet e mësipërme, KLP-ja ka mbajtur qëndrimin për pezullimin e procedimit disiplinor deri në momentin kur, ndaj magjistratëve në fjalë, të përfundojë procesi i rivlerësimit kalimtar me vendim të KPA-së.

Me rënien e shkakut të pezullimit (nëse magjistratët konfirmohen në detyrë), KLP-ja do të vijojë procedurën disiplinore ndaj tyre, sipas rregullimeve të Ligjit për Statusin.

### **c. Hetime disiplinore të filluara nga ILD**

Përveç procedimeve disiplinore të përmendura më sipër, gjatë këtij viti, KLP-ja është informuar se, ILD-ja ka filluar hetimin disiplinor ndaj magjistratëve A.P., M.S., E.R., dhe R.K., për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 101, pika 1, shkronja “a”, neni 102, pika 1, shkronjat “ç”, “d”, “dh” dhe “ë”, të Ligjit për Statusin.

Për një nga rastet e mësipërme, këshilli ka vendosur pezullimin e procedimit disiplinor (E.R.) dhe për rastin tjetër, ILD-ja ka njoftuar për përfundimin e hetimit disiplinor pa konstatuar shkelje disiplinore (R.K.).

Për dy rastet e tjera, me paraqitjen e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor nga ana e ILD-së, këshilli do të zhvillojë procedurën disiplinore në ngarkim të magjistratëve në fjalë.

### **d. Hartimi dhe miratimi i akteve, relacioneve, projekt-vendimeve të Komisionit Disiplinor dhe këshillit**

Në përputhje me përgjegjësitë e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore për këshillin dhe, Komisionin Disiplinor janë hartuar dhe administruar të gjitha aktet procedurale që përbëjnë procesin disiplinor që zhvillohet nga Këshilli.

Për procedurat disiplinore të trajtuara gjatë vitit 2022 janë përgatitur procesverbalet, relacionet paraprake dhe përfundimtare, vendimet, njoftimet dhe çdo korrespondencë tjetër zyrtare në funksion të procedurës disiplinore në ngarkim të prokurorëve për të cilët është paraqitur kërkesa për procedim disiplinor nga ILD-ja.

### **e. Regjistri disiplinor**

Në përputhje me nenin 150, të Ligjit për Statusin dhe nenin 15, të Rregullores “*Mbi funksionimin e Komisionit Disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve*”, KLP-ja ka përgatitur Regjistrin disiplinor.

Ky Regjistër i cili administrohet nga Komisioni Disiplinor, përmban të dhënat që kanë të bëjnë me: *çështjet në lidhje me procedimet disiplinore, si dhe vendimet e formës së prerë të marra në këto procedime, si dhe të gjithë ecurinë që i përket fazës së ekzekutimit të masave disiplinore.*

Në Regjistrin disiplinor janë pasqyruar të dhënat që i përkasin 2 (dy) procedimeve disiplinore të përfunduara gjatë vitit 2022, si dhe dinamika e veprimtarisë së Komisionit Disiplinor, në lidhje me këto procedura.

Komisioni Disiplinor ka punuar për hartimin e një drafti të rregullores së përbashkët për bashkimin e procedimeve disiplinore mes KLP-së dhe KLGJ-së, në përputhje me nenin 140, të Ligjit për Statusin.

Përpara miratimit të saj është i nevojshëm konsultimi me KLGJ-në, por edhe ILD-në, duke patur parasysh specifikën që paraqet zhvillimi në praktikë i një procedure disiplinore për dy apo më shumë magjistratë (prokurorë dhe gjyqtarë) nga dy trupa të ndryshme administrative siç janë KLP-ja dhe KLGJ-ja.

Gjatë vitit 2022, në ushtrimin e detyrave të tij, Komisioni Disiplinor është ndihmuar nga personeli i Njësisë së Mbështetjes së Komisioneve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore të Këshillit, të cilët kanë mundësuar zhvillimin me efektivitet të punës.

## **Komisionet e tjera**

### **22. Veprimtaria e Komisionit për mbrojtjen e prokurorëve**

Referuar nenit 20 të Ligjit për Statusin dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 564, datë 31.07.2019 *“Për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e veçantë të magistratit gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij”*, magistratit prokuror i sigurohet mbrojtje e veçantë personale, e familjes dhe e pasurisë, kur gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij, i rrezikohet jeta, shëndeti i tij ose i familjes, si dhe pasuria. Mbrojtje e veçantë i sigurohet edhe magistratit që nuk e ushtron funksionin ose që ka dalë në pension, me kërkesë të tij, në rast se cënimi lidhet me ushtrimin të mëparshëm të funksionit. Me mbrojtje të veçantë personale, të familjes dhe të pasurisë, do të kuptohen masat me karakter organizativ e profesional, për sigurimin dhe ruajtjen e veçantë fizike, mbrojtjen e familjes e të pasurisë së magistratit, si dhe masat e tjera, që lidhen me këtë mbrojtje.

Kërkesa për mbrojtje të veçantë i paraqitet Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve me shkrim nga magistrati, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ministri i Drejtësisë, kryetari i gjykatës ose drejtuesi i prokurorisë, ku magistrati ushtron funksionin, si dhe çdo organ tjetër publik që, për shkak të funksionit, merr dijeni për praninë e rrethanave serioze që rrezikojnë jetën, familjen ose pasurinë e magistratit.

Për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2022, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve janë administruar 8 (tetë) kërkesa për mbrojtje nga magistratë prokuror të cilët kanë konstatuar se për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit gjendeshin në rrethana serioze që rrezikonin jetën e tyre dhe të familjes së tyre.

Jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga paraqitja e kërkesës, Komisioni për Mbrojtjen e Prokurorëve ka marrë në shqyrtim kërkesat e paraqitura dhe pas vlerësimit të rrethanave të parashtruara dhe atyre që janë konstatuar gjatë hetimit administrativ, të 8-ta kërkesat e paraqitura janë pranuar dhe shqyrtuar. Vendimet e Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve në mënyrë të menjëhershme i janë dërguar për zbatim strukturave të Policisë së Shtetit të cilat kanë marrë masat për të garantuar mbrojtjen fizike të magistratëve prokuror.

Objekti i 7 (shtatë) kërkesave të paraqitura para Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve për vitin 2022, ka qenë zgjatja e afatit të mbrojtjes për shkak se vazhdojnë të ekzistojnë rrethana që kanë çuar në vendosjen e masave mbrojtëse të cilave iu ka përfunduar afati.

Kërkesat për zgjatjen e afatit të masave mbrojtëse pas administrimit janë trajtuar me prioritet nga Komisioni për Mbrojtjen e Prokurorëve, për shkak se është vlerësuar prania e rrethanave serioze që rrezikojnë jetën, familjen ose pasurinë e magistratit si dhe prania e lidhjes shkakësore ndërmjet rrethanave serioze dhe ushtrimit të funksionit ose ushtrimit të mëparshëm të funksionit nga magistrati. Komisioni për Mbrojtjen e Prokurorëve, pas shqyrtimit të kërkesës, vlerëson masat e marra nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe vendos, kur është rasti, për vazhdimin e mëtejshëm të tyre.

Vendimet e komisionit për zgjatjen e afatit të masave të mbrojtjes i janë dërguar për zbatim strukturave të Policisë së Shtetit të cilat kanë siguruar marrjen e masave të nevojshme për të garantuar mbrojtjen fizike të magistratëve prokuror.

Gjatë vitit 2022 rezultoi se vetëm 1 (një) kërkesë është bërë për herë të parë dhe është vlerësuar me urgjencë rasti. Drejtuesi i prokurorisë ku ushtronte funksionin magjistrati, ju drejtua me kërkesë emergjente Komisionit dhe menjëherë, kryetari i komisioni duke vlerësuar se rreziku ndaj magjistratit ishte serioz dhe i çastit, mori masa të menjëhershme duke komunikuar me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ky i fundit urdhëroi strukturat e Policisë së Shtetit të merrnin masa të menjëhershme për të garantuar jetën, familjen ose pasurinë e magjistratit, deri në mbledhjen e komisionit.

Vendimet e Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve për dhënien e mbrojtjes së veçantë fizike të prokurorëve ose zgjatjen e dhënies së mbrojtjes së veçantë janë vlerësuar me afat kohor si vijon;

- Për 4 (katër) kërkesa është vendosur afati 3 (tre muaj) për mbrojtje fizike;
- Për 2 (dy) kërkesa është vendosur afati 6 (gjashtë muaj) për mbrojtje fizike;
- Për 2 (dy) kërkesa është vendosur afati 1 (një vjeçar) për mbrojtje fizike;

Konstatohet se deri në Dhjetor 2022 janë në mbrojtje të veçantë 5 (pesë) prokurorë.

Duke patur në konsideratë shtrirjen gjeografike të kërkesave për mbrojtje të veçantë përgjatë vitit 2022, konstatohet që këto kërkesa janë paraqitur kryesisht nga magjistratë prokuror që ushtrojnë funksionet, kryesisht, në prokuroritë më të mëdha të vendit. Kjo shtrirje gjeografike e kërkesave për mbrojtje vazhdon të qëndrojë në zonat ku ka aktivitet të shtuar dhe të rëndë kriminal.

Komisioni për Mbrojtjen e Prokurorëve gjatë vitit 2022 mbledhjet e tij i ka zhvilluar në ambientet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me pjesëmarrjen e anëtarëve të tij duke siguruar në çdo rast kuorumin e nevojshëm sipas përcaktimit në VKM-në Nr.564, datë 31.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e veçantë të magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij”.

Funksionaliteti i Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve orientohet kryesisht në garantimin e mbrojtjes së veçantë të magjistratit prokuror me kërkesë të tij ose me marrjen dijeni për situata serioze që cenojnë jetën, shëndetin dhe pasurinë e magjistratit ose të familjarëve të tij. Në aspektin sasior është e pamundur të parashikohet ecuria e komisionit edhe pse numrat relativisht të ulët janë tregues suksesi në luftën kundër kriminalitetit. Përsa i përket aspektit cilësor, veprimtaria e Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve ka qenë e menjëhershme duke mos tejkaluar në asnjë rast afatin prej 48 (dyzetë e tetë) orësh nga momenti i marrjen së kërkesës.

Anëtarët e komisionit kanë vlerësuar në çdo rast njoftimet për mbledhjet e komisionit, duke siguruar jo vetëm pjesëmarrjen por edhe duke shqyrtuar me seriozitet dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie kërkesat e paraqitura dhe kushtet e rrethanat specifike të secilit magjistrat.

Bashkëpunimi i Komisionit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit gjatë vitit 2022 ka qenë në nivelin më të lartë. Në të gjitha rastet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka siguruar zbatimin e vendimeve të Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve duke vendosur mbrojtje efektive dhe funksionale për magjistratët dhe në një rast ka vendosur mbrojtjen për magjistratin prokuror me urgjencë deri në shqyrtimin e kërkesës nga komisioni.

Në përmbushje të detyrave funksionale që lindin nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ligjore dhe nënligjore të dala në funksion dhe në zbatim të mbrojtjes së veçantë të magjistratit prokuror, Komisioni për Mbrojtjen e Prokurorëve pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është në gjendje gatishmërie për vepruar në kohë reale së bashku me anëtarët e

tjerë të komisionit për trajtuar kërkesat për mbrojtje të veçante si dhe informacionet nga personat e tretë, me qëllim për të garantuar magjistratët prokuror në luftën kundër kriminaliteti.

### **23. Komisioni i Posaçëm për shqyrtimin e ankesave kundër arkivimit të hetimit nga ana e ILD-së**

Ky Komision i Posaçëm ka si objekt të veprimtarisë së tij shqyrtimin e ankesave të subjekteve kundër vendimeve të ILD-së për arkivimin dhe mbylljen e hetimit ndaj prokurorëve. Në kuadër të kësaj veprimtarie ky komision ka trajtuar 26 ankesa. Në të gjitha rastet komisioni ka konkluduar me lënien në fuqi të vendimeve të ILD-së. Kjo për shkak se, vendimmarrja e komisionit kufizohet në kryesisht në vlerësimin e vendimeve të ILD-së në raport me verifikimin e kushteve të pranueshmërisë së ankesave dhe nga ana tjetër vendimmarrja e ILD-së në lidhje me vendimet objekt shqyrtimi nga ky komision ka qenë objektive dhe e bazuar në ligj.

### **H. Rezoluta e fundit e Kuvendit, zbatimi dhe sfidat e KLP për vitin 2023**

#### **24. Niveli i zbatimit të rezolutës së Kuvendit “Për raportin vjetor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2020”**

Më datë 14.07.2021, Kuvendi ka miratuar Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së KLP-së për vitin 2021.

Bazuar në rekomandimet e Rezolutës, Kuvendi i Shqipërisë nxit KLP-në:

#### ***i. Të veprojë me ritme të shpejta për adresimin e zgjidhjeve të problematikave në sistemin e prokurorisë, veçanërisht në reduktimin e emërimeve të përkohshme***

Numri i caktimeve të përkohshme po ulet ndjeshëm për shkak të ndryshimit të hartës gjyqësore si dhe për shkak të emërimeve të përhershme të prokurorëve të rinj dhe të drejtësueve të disa prokurorive. Konkretisht, në fund të vitin 2022 rezultojnë të caktuar përkohësisht 5 prokurorë dhe 14 drejtues. Me implementimin e hartës së re gjyqësore numri i drejtueseve të caktuar përkohësisht ka zbritur në 9 prokurorë ndërsa prokurorë të caktuar përkohësisht ka zbritur në 3. Këto numra priten të reduktohen ndjeshëm pas emërimit dhe caktimit në pozicion të 26 magjistratëve të rinj në Korrik 2023 si dhe për shkak të emërimit të drejtueseve të tjerë të cilët janë në proces shqyrtimi administrativ. Duke pasur në konsideratë, mungesat e shumta në sistemin e prokurorisë vlerësojmë se ky numër ka qenë mjaft i ulët.

#### ***ii. Të bëjë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e problematikave apo kapërcimin e sfidave që vijnë nga vakancat e krijuara në sistem në kuadër të parimit të funksionalitetit dhe mirëfunksionimit të sistemit prokurorial***

Roli i Këshillit të Lartë të Prokurorisë kufizohet në propozimin e kuotave vjetore për praninë në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, i cili në çdo rast negociohet me vetë shkollën në raport me kapacitetet e saj. Për vitin akademik 2023-2024, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka propozuar 40 vende për magjistrat prokuror, të cilat janë miratuar nga SHM-ja. Ndërkohë priten të diplomohen edhe 78 prokuror për tre vitet e ardhshme. Nga ana tjetër Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kërkuar ndryshime ligjore në lidhje me uljen e përkohshme të kohëzgjatjes së Shkollës së Magjistraturës në 2 vite akademike.

- iii. Të forcojë bashkëpunimin me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe institucionet e tjera shtetërore në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për të gjitha proceset që ndikojnë në zbatimin e duhur dhe efektiv të reformës në drejtësi.*

Në kuadër të këtij rekomandimi është mundësuar bashkëpunimi institucional ndërmjet institucioneve duke caktuar person kontakti përgjegjës për shkëmbim informacioni. Ndërsa Mbledhja e Përbashkët me Këshillin e Lartë Gjyqësor është shtyrë pas implementimit të plotë të hartë së re gjyqësore. Përfaqësuesit e ILD-së, Shkollës së Magjistraturës, Prokurorit të Përgjithshëm, MD-së dhe OPDAT-it janë ftuar dhe kanë marrë pjesë në çdo aktivitet/mbledhje plenare të KLP-së për të cilat kanë pasur interes.

- iv. Të vazhdojë t'i kushtojë rëndësi komunikimit me publikun për veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë*

Në kuadër të këtij rekomandimi është caktuar Koordinatori për të Drejtën e Informimit si dhe është implementuar plotësisht programi i transparencës për këtë qëllim.

- v. Të informojë vazhdimisht Kuvendin e Shqipërisë për problematikat e hasura në sistemin e prokurorisë duke rekomanduar edhe zgjidhjet përkatëse.*

Në vijim të këtij rekomandimi, mund të vlerësohen propozimet për ndryshime ligjore të cilat në thelb shprehin problematikat ekzistuese me të cilat është hasur Këshilli i Lartë i Prokurorisë gjatë vitit 2022.

## **25. Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2022 i rekomandon KLP-së:**

- i. Të bashkëpunojë me Prokurorin e Përgjithshëm me qëllim ndjekjen e zbatimit të udhëzimeve me karakter të përgjithshëm nga prokurorët e të gjitha niveleve dhe të angazhohet për rezultate konkrete në këtë drejtim*

Referuar nenit 47, të ligjit Nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, prokurori mund të kundërshtojë paligjshmërinë apo pabazueshmërinë e udhëzimeve të përgjithshme të drejtuesit më të lartë, duke bërë ankim në KLP. Gjatë gjithë veprimtarisë së tij, deri më sot, KLP-ja ka shqyrtuar administrativisht 3 ankesa të prokurorëve përkundrejt udhëzimeve të përgjithshme të drejtuesve më të lartë.

- ii. Të vijojë procedurat për përzgjedhjen e prokurorëve të tjerë të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për të bërë të mundur sa më shpejt plotësimin e vendeve të lira në këtë institucion në zbatim të vendimit të Kuvendit nr. 6, datë 28.1.2021*

Në vijim të këtij rekomandimi, vlen të theksohet se Prokuroria e Posaçme ka një organikë prej 20 prokurorësh në të cilën janë emëruar 17 prokurorë. Aktualisht, është transferuar përkohësisht dhe 1 prokuror. Në raport me vakancat e shumta që ka sistemi i prokurorisë, Prokuroria e Posaçme ka përqindjen më të ulët të vakancave. Megjithatë duke pasur në konsideratë se, rregullorja "Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar" e miratuar nga Këshilli në vitin 2019, ka pasur si qëllim krijimin fillestar të kësaj prokurorie, si dhe për të përcaktuar kriteret që garantojnë rritjen e mëtejshme të cilësisë së prokurorëve që do të emërohen në

këtë prokurori, ka lindur nevoja e hartimit të një rregulloreje të re. Aktualisht është përfunduar drafti paraprak dhe është në fazë konsultimi. Në perspektivën e uljes së vakancave të sistemit të prokurorisë në juridiksionin e përgjithshëm, brenda këtij viti pritet që edhe vakancat e mbetura në Prokurorinë e Posaçme të plotësohen.

**iii. *Të përmbyllë në një kohë sa më të shkurtër hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore sipas përcaktimeve në ligjet e reformës së drejtësisë, si dhe hartimin, miratimin dhe zbatimin e rregullave më të detajuara për formimin fillestar dhe atë vazhdues për nëpunësit e tjerë civilë të prokurorisë***

Gjatë vitit 2022, Kryetari i KLP-së, në vijim të këtij rekomandimi, ka evidentuar të gjitha aktet nënligjore që duhen hartuar sipas detyrimeve të përcaktuara në paketën e ligjeve në reformën në drejtësi. Në përmbushje këtij detyrimi, janë ngritur 12 grupe pune për hartimin e këtyre akteve. Aktualisht janë miratuar 5 rregullore dhe është ndryshuar 1, konkretisht:

1. “Standardet etikës dhe rregullat e sjelljes së prokurorit”
2. “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”
3. “Për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm”
4. “Për komunikimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me median”
5. “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”
6. Për një ndryshim në rregulloren “Për procedurën e lëvizjes paralele të prokurorëve”

Të gjitha rregulloret e mbetura, për shkak të kompleksitetit të çështjeve janë në fazë përfundimtare dhe së shpejti pritet miratimi i tyre.

**iv. *Të përgatisë dhe të miratojë programin e përvitshëm për vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të prokurorëve dhe fillimin e procesit të vlerësimit menjëherë. Këshilli të paraqesë një raport të detajuar për zbatimin e këtij rekomandimi brenda muajit shtator 2022***

Me vendimin Nr.140, datë 06.06.2022, KLP-ja vendosi miratimin e “Programit që përvakton listën e prokurorëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional përgjatë vitit 2022”

**v. *Me qëllim përmbushjen e detyrimeve të nenit 170, të ligjit Nr.115/2016 të organizohen takime të përbashkëta mbi baza periodike me Këshillin e Lartë Gjyqësor duke vendosur theksin në unifikimin e interpretimit dhe zbatimit të ligjeve dhe forcimin e bashkëpunimit institucional***

Mbledhja e përbashkët me KLGJ është shtyrë pas implementimit të plotë të hartë së re gjyqësore.

**vi. *Në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, të miratohen rregullat e përbashkëta për bashkimin e procedimeve në rastin kur një gjyqtar dhe një prokuror janë përfshirë në të njëjtën shkelje***

KLP-ja ka përgatitur një draft paraprak për përcaktimin e rregullave të përbashkëta për bashkimin e procedimeve disiplinore, i cili do të diskutohet në Mbledhjen më të parë të përbashkët ndërmjet dy Këshillave.

- vii. ***Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe specifikimeve të nenit 185 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të mbajë dhe të artikulojë publikisht qëndrimet përkatëse për të garantuar pacenueshmërinë dhe mosndikueshmërinë në ushtrimin e funksioneve ligjore të prokurorëve***

Gjatë vitit 2022, KLP-ja nuk ka pasur asnjë kërkesë nga e prokurorëve për mbajtjen e një qëndrimi publik.

- viii. ***Të forcohet bashkëpunimi institucional me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Shkollën e Magjistraturës në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë dhe kapërcimit të sfidave që krijohen nga vendet e lira në sistem***

Përfaqësuesit e ILLD-së, SHM-së, Prokurorit të Përgjithshëm, MD-së dhe OPDAT-it janë ftuar dhe kanë marrë pjesë në çdo aktivitet të KLP-së për të cilat kanë pasur interes.

- ix. ***Të intensifikojë bashkëveprimin me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, me qëllim trajtimin në afate të arsyeshme të procedimeve disiplinore për prokurorët, duke pasur prioritet subjektet në proces rivlerësimi***

Në të gjitha rastet që KLP-ja është investuar me kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor, ka respektuar me përpikëri afatet procedurale të përcaktuar në ligj. Vendimmarrjet e KLP-së janë konfirmuar nga KPA-ja.

- x. ***Të ndjekë dhe të konsiderojë me përparësi angazhimet, detyrimet ligjore dhe funksionale që burojnë nga procesi i zbatimit të hartës gjyqësore***

KLJGJ, me Vendimin Nr.505, datë 21.11.2022, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, ka filluar ristrukturimin e Gjykatave të Apelit, duke i grupuar ato në një të vetme të emërtuar Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm. Gjykata e Apelit Tiranë emërtohet Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm. Gjykatat që shkrihen janë Gjykatat e Apelit Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë.

KLP-ja ka marrë të gjitha masat që harta e re gjyqësore sa i takon prokurorive pranë gjykatave të apelit të implementohet me datë 01.02.2023. Në datën 1 Maj 2023 do të fillojë implementimi i hartës së re gjyqësore në nivelin e prokurorive të shkallëve të para, Këshilli i Lartë i Prokurorisë angazhohet për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor.

- xi. ***Me qëllim rritjen e mëtejshëm të transparencës së Këshillit, të publikohen në kohë vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve plenare dhe Komisioneve të Përhershme sipas përcaktimeve të neneve 167 dhe 168 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe të përpunohet informacioni ndaj publikut në mënyrë sa më të unifikuar dhe të kuptueshme në faqen zyrtare të institucionit***

Në zbatim të ligjit, të gjitha vendimet e KLP-së, procesverbalet dhe audiot e seancave plenare, në përfundim të procesit të anonimizimit, publikohen në faqen zyrtare të internetit të Këshillit. Duke iu referuar dhe ndërfaqes së web-it ato janë lehtësisht të aksesueshme për çdo përdorues, duke mundësuar edhe mekanizimin e kërkimit të tyre.



***xii. Të plotësojë pa vonesa rekomandimet për Këshillin në progresraportin e Bashkimit Evropian të vitit 2021, si dhe detyrimet e tjera që rrjedhin nga procesi i integritimit me Bashkimin Evropian të Shqipërisë***

Sipas Raportit të Progresit të BE, publikuar më datë 19.10.2021, është përcaktuar se KLP-ja duhet të sigurojë një bashkëpunim të ngushtë me Prokurorin e Përgjithshëm në mënyrë sa më transparente. Gjithashtu, sipas Progres Raportit, KLP-ja duhet të finalizojë rregullat dhe procedurat për vlerësimin e prokurorëve. Së fundi, KLP-ja është përgjegjës për miratimin dhe monitorimin e rregullave të etikës dhe sjelljes së prokurorëve.

Lidhur me këto rekomandime dhe gjetje të BE, në Progres Raportin e vitit 2021, sqarojmë se KLP-ja është përpjekur të përmbushë rekomandimet e vendosura nga ky raport, duke vijuar me një bashkëpunim të ngushtë me Prokurorin e Përgjithshëm, ashtu sikurse në vitet e mëparshme të raportimit. Gjithashtu, KLP-ja ka patur gjithashtu në vëmendje dhe ka punuar intensivisht për hartimin dhe miratimin e rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve, e cila është finalizuar me Vendimin Nr. 95, datë 09.05.2022. Së fundi, sa i përket rregullave të etikës dhe sjelljes së prokurorëve, KLP-ja ka miratuar Standardet e etikës dhe sjelljes së prokurorëve, finalizuar me Vendimin Nr.32, datë 24.02.2022.

Sa i përket detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit të Shqipërisë në BE, KLP-ja ka raportuar për kontributin e dytë të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, Kontratën Sektoriale “BE për Reformën në Drejtësi”, monitorimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian, Komitetit të Stabilizim Asociimit dhe Nënkomitetit për Kapitullin 23 pranë Zyrës së Kryenegociatorit etj.

Po në këtë kuadër, KLP-ja ka raportuar dhe ka marrë pjesë më datë 15.02.2022, në takimin e njëmbëdhjetë të Komitetit të Stabilizim Asociimit. Gjithashtu, në datat 26-27 shtator 2022, KLP-ja mori pjesë në takimin shpjegues për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” në Bruksel, mbi zhvillimet e acquis që prej shtatorit të vitit 2018 e në vijim.

Në vijim të këtij takimi, në datat 24-25 Nëntor 2022, u zhvillua takimi i dytë në Bruksel, i cili kishte për qëllim raportimin përpara zyrtarëve të lartë të Komisionit Evropian, mbi arritjet e deritanishme të sistemit gjyqësor e prokurorial.

Në këtë kuptim, KLP-ja gjatë vitit 2022 ka përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritimit në BE, si anëtar i Grupit të Punës për Kapitullin 23.

***xiii. Të vijojë dhënien e opinioneve dhe vlerësimeve për përmirësimet ligjore në përputhje me përcaktimet e nenit 187 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”***

KLP-ja ka dhënë dhe do të vijojë të japë në vazhdimësi opinione dhe vlerësimi për përmirësimin e ligjeve organike dhe të paketës së reformës në drejtësi, brenda kompetencave funksionale të tij.

Në mbështetje të nenit 187, Ligjit për Qeverisjen, KLP-ja ka dhënë përgjigje për kërkesat e ardhura nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Kryeministria etj., për të dhënë mendim mbi disa projektakte si:

1. Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
2. Projektligji “Për të drejtën e informimit”;
3. Projektligji “Për informacionin e klasifikuar”;

4. Projektligj “Kodi Penal”;
5. Projektligj “Kodi i Procedurës Penale”;
6. Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
7. Projektmarrëveshja “Për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin e Drejtësisë për vitet 2021-2027”;
8. Projektvendimi “Për miratimin e Planit të Veprimit 2023-2025 në zbatim të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025”;
9. Projektvendim “Strategjia e Drejtësisë për të Miturit”;
10. Projektligji “Konventa e Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare””;
11. Projektvendimi “Për miratimin e rregullave të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore, rregullat për ndërveprim me bazat e tjera të të dhënave shtetërore, si dhe nivelin e aksesimit në regjistrin elektronik të gjendjes gjyqësore të shtetasve të dënuar jashtë vendit, por me banim të përbërshëm në shtetin shqiptar”;
12. Projektvendimi “Për përcaktimin e kriterëve dhe rregullave për përzgjedhjen, kontraktimin dhe shpërblimin e përkthyesve zyrtarë, si dhe mënyrën e kontrollit të shërbimit të kryer nga përkthyesit zyrtarë”;
13. Projektvendimi “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për të dhënat që përmban regjistri elektronik i përkthyesve zyrtarë dhe interpretëve të gjuhëve të shenjave, dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave si dhe nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara”;
14. Projektvendim “Protokolli “Për përpunimin automatik të të dhënave personale””;
15. Projektvendim “Protokolli i dytë shtesë të Konventës së Këshillit të Evropës “Për krimin kibernetik, mbi bashkëpunimin e zgjeruar dhe zbulimin e provave””;

## **26. Konkluzione të nxjerra nga veprimtaria e vitit 2022 dhe sfidat për vitin 2023**

KLP-ja, gjatë vitit 2022, ka marrë gjithsej 333 vendime, në 35 mbledhje plenare të zhvilluara. Vendimmarrja ka qenë kryesisht e lidhur me akte administrative individuale në funksion të karrierës së prokurorëve.

KLP-ja gjatë vitit 2022 ka hartuar dhe miratuar gjashtë akte nënligjorë, të cilët janë tepër të rëndësishëm dhe në funksion të karrierës së prokurorëve, si: Rregullorja për komunikimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me median, Rregullorja për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Rregullorja për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve, Standardet e etikës dhe sjelljes së prokurorëve, Rregullorja për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe ndryshimet në Rregulloren për lëvizjen paralele të prokurorëve.

Gjatë vitit 2022, në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë të drejtuesve të zyrave të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, ka përfunduar procedura për ngritje në detyrë për 1 (një) prokuror. Janë në proces edhe 9 (nëntë) procedura të tjera për ngritje në detyrë në pozicion drejtuesi dhe 1 (një) procedurë për transferim nëpërmjet lëvizjes paralele.

Lidhur me ngritjen në detyrë në pozicionin e drejtuesit të SPAK, më datë 19.09.2022, KLP-ja shpalli thirrjen për fillimin e procedurave për plotësimin e pozicionit vakant për Drejtues të SPAK, për të cilën shprehën interesin 3 (tre) kandidatë. Më datë 16.12.2022, pas prezantimit të platformave të secilit kandidat, KLP-ja zgjodhi zotin Altin Dumani si drejtues të SPAK.

Një kompetencë tjetër e KLP-së lidhet me verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në Programin e Formimit Fillestar, si dhe kandidatët për prokurorë, pas përfundimit të këtij programi. Për vitin 2022, nga ana e KLP-së janë emëruar 22 prokurorë të rinj, ndërsa nga 29 kandidatë që aplikuan për t'u pranuar në Shkollën e Magjistraturës, KLP-ja ka miratuar 26 vendime lejimi, 1 vendim ndalimi dhe për 2 kandidatë të tjerë pritet vendimmarrja gjatë vitit 2023.

Lidhur me një komponent tjetër të rëndësishëm të KLP-së, është trajtimi i rasteve të propozuara për fillim procedimi disiplinor dhe dhënien e masës përkatëse prokurorëve përkatës. KLP-ja, për dy kërkesa për fillim procedimi disiplinor nga ana e ILD-së, me propozim dhënien e masës disiplinore "Vërejtje publike", vendosi rrezimin e kërkesës së ILD-së, për dhënien e masës disiplinore për dy prokurorë.

Ndërsa në një procedim tjetër, ku u kërkua nga ILD-ja fillimi i procedimit disiplinor dhe u propozua dhënia e masës disiplinore "Shkarkim nga detyra", KLP-ja vendosi pranimin e kërkesës së ILD-së për shkarkimin e një prokurorëje. Aktualisht, kjo vendimmarrje është duke u shqyrtuar nga KPA-ja, pasi prokurorja në fjalë ka ushtruar të drejtën e ankimit.

Së fundi, lidhur me procedimin disiplinor të filluar me kërkesë të ILD-së, ndaj një prokurori, KLP-ja vendosi pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj prokurorit, deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, me vendim përfundimtar.

Gjithashtu, KLP-ja, si organ përgjegjës për miratimin e Rregullave dhe Kodit të Etikës dhe për monitorimin e tyre, miratoi "*Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së prokurorit*", si dhe komandoi zotin Hysen Keta në pozicionin e Këshilltarit për Etikën pranë KLP-së.

Për periudhën në vazhdim, një prej komponentëve themelorë të veprimtarisë së KLP-së, i cili është në fokusin aktual të punës është procesi i vlerësimit etiko-profesional të prokurorëve. KLP-ja ka miratuar Rregulloren për Vlerësimin Etik dhe Profesional të Prokurorëve; Programin që përcakton listën e prokurorëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi përgjatë vitit 2023; Planin tre-mujor të vlerësimit; dhe ka caktuar me short relatorët dhe këshilltarët ligjorë përgjegjës për procedurën e vlerësimit të prokurorëve.

Hartimi i rregullores për Vlerësimin Etik dhe Profesional të Prokurorëve dhe anekseve që shoqërojnë këtë rregullore ka rezultuar të jetë një punë e vështirë dhe KLP-ja ka arritur ta realizojë me sukses në 6-mujorin e parë të vitit 2022.

Rregullorja për vlerësimin e prokurorëve është tepër komplekse dhe KLP-ja është hasur me vështirësi të ndryshme në zbatimin në praktikë të saj, për shkaqe si vijon:

**Së pari,** krijimi i vakancave si pasojë e Vetting-ut, ka shkaktuar një mbingarkesë të prokurorëve, gjë që nuk reflekton punën e tyre në një situatë normale. Kriteret e tilla që janë thelbësore në vlerësimin profesional si: ngarkesa mesatare apo respektimi i afateve ligjore në hetimin e një çështje, në këto kushte bëhet i vështirë për t'u vlerësuar.

**Së dyti,** numri i reduktuar i prokurorëve në zyrat e prokurorisë vështirëson shumë punën e angazhimit të tyre në këtë proces, pasi duhet të seleksionohen dosje, duhen dhënë statistika për tre ose pesë vite, duhet të plotësohen formularët e vetëvlerësimit nga ana e tyre, formularët e vlerësimit nga ana e drejtuesve etj.

**Së treti,** implementimi i rregullores ka nevojë thelbësore, gjenerimin e të dhënave të sakta statistikore, të cilat aktualisht në zyrat e prokurorive hidhen manualisht.

**Së katërti,** KLP-ja ka patur në fokus disa procese të tjerë të rëndësishëm si: plotësimi i vakancave në SPAK, emërimi i drejtuesit të ri të SPAK-ut, realizimi i procedurave të

transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në funksion të karrierës së prokurorëve etj.

**Së pesti,** KLP-ja gjatë funksionimit të tij, i ka dhënë prioritet mbështetjes së institucioneve të Vetting-ut, duke dërguar në një afat sa më të shpejtë raportet mbi vlerësimin etiko-profesional të magjistratëve prokurorë, të cilët janë në proces verifikimi.

Po kështu, në kuadër të mbështetjes që KLP-ja i ka dhënë dhe vazhdon të japë për KPK-në, në shërbim të këtij procesi, KLP-ja ka komanduar 6 prokurorë në pozicionin e këshilltarit, për një periudhë tre-vjeçare, me anë të vendimeve nr. 66-71, datë 24.02.2020. Aktualisht në KLP janë ende të komanduar 5 prokurorë, ndërsa për 1 prokuror është ndërprerë periudha e komandimit para përfundimit të afatit. Afati i komandimit për këta prokurorë përfundon në fillim të vitit 2023, ku pritet të komandohen sërish 5 prokurorë të rinj në pozicionin e këshilltarit. Prokurorët e komanduar do të merren me procesin e vlerësimeve periodike etiko-profesionale, por duke qenë se institucioneve të rivlerësimit iu zgjat kohëzgjatja e mandateve Kushtetuese deri në vitin 2023, prokurorët e komanduar do të vijojnë edhe funksionet e tyre mbështetëse ndaj KPK-së.

**Së gjashti,** KLP-ja gjatë vitit 2022 ka angazhuar burimet njerëzore edhe për hartimin e pesë akteve të tjerë nënligjorë (ku përfshihet edhe rregullorja e vlerësimit të prokurorëve në prokurorinë e përgjithshme), të cilët janë tepër të rëndësishëm dhe në funksion të karrierës së prokurorëve.

Sikurse edhe vitin e kaluar, sfida kryesore mbetet plotësimi i vakancave deri në përfundim të procesit të rivlerësimit, për të garantuar funksionimin normal dhe efektshmërinë e veprimtarisë së prokurorëve. Edhe pse roli i KLP-së në këtë drejtim është dytësor, sikurse e përmendëm më sipër, jemi përpjekur për të adresuar këtë problematikë duke bërë propozimet tona për ndryshime ligjore që do të mundësonin përfshirjen në sistem gjatë kësaj periudhe, të një numri të konsiderueshëm prokurorësh të rinj, pa cenuar standardet dhe cilësinë e sistemit. Në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës kemi dakordësuar pranimin në këtë vit akademik të një numri prej 40 studentesh.

Bashkëpunimi i KLP-së me Shkollën e Magjistraturës është një prioritet tjetër për të ardhmen. Përgjatë këtyre viteve, KLP-ja dhe SHM-ja kanë pasur një marrëdhënie periodike pune, të lidhur me disa procese të rëndësishëm si: emërimi dhe caktimi në detyrë i prokurorëve të rinj, verifikimi i studentëve të pranuar për të vijuar Programin e Formimit Fillestar, miratimi i kalendarëve të trajnimeve vazhdues të prokurorëve, përgatitja e kurrikulave për kancelarët etj.

Plotësimi i organikës së Prokurorisë së Posaçme me tre prokurorë të tjerë (për të përmbushur numrin prej 20 prokurorësh të miratuar me vendim të Kuvendit) do të jetë një objektiv tejet i arritshëm gjatë vitit 2023, pasi aktualisht KLP, ka përfunduar draftin e rregullores për ngritjen në detyrë të prokurorit të SPAK, për shkak se rregulloja aktuale ishte konceptuar për fazën e krijimit të kësaj strukture dhe nuk i përgjigjet situatës aktuale ku kjo prokurori funksionin me të gjitha strukturat e parashikuara nga ligji, të nevojshme për këtë proces. Kjo rregullore është në fazë konsultimi dhe pritet të miratohet së shpejti.

Megjithatë kjo procedurë do jetë e ndërvarur me nevojat emergjente që ka sistemi i prokurorisë duke mos prishur balancat me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm në vend, pasi aktualisht kjo prokurori ka në organikën e saj 17 prokurorë dhe të dhënat e ngarkesës së volumit në punë në hetim, referuar raportit të SPAK, paraqiten si më poshtë:

Në Prokurorinë e Posaçme për periudhën e vitit 2022 janë hetuar gjithsej 712 procedime penale, nga të cilat 455 procedime penale janë mbartur nga viti 2021, ndërsa 257 procedime

penale janë regjistruar gjatë vitit 2022 si procedime penale të reja. Ngarkesa mesatare faktike rezulton të jetë 42 procedime penale.

Një aspekt tjetër që do të përbëjë një prej sfidave të fillimit të vitit 2023 për KLP-në, është implementimi i hartës së re gjyqësore. Menjëherë pasi Prokurori i Përgjithshëm të miratojë strukturën organike të prokurorive pranë Gjykatave të Shkallëve të Para dhe Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, KLP-ja do të kryejë procesin e ristrukturimit të prokurorive të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, i cili do të zbatohet me datë 01.02.2023, ndërsa në nivelin e prokurorive të shkallës së parë do të fillojë më 01.05.2023. Ky proces do të kryet në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm, duke bërë një analizë të ngarkesës së punës për secilën prokurori.

Në aspektin infrastrukturor, një synim i KLP-së për vitin 2023 është digjitalizimi e arkivave të sistemit të tij dhe të sistemit të prokurorisë në tërësi me qëllim rritjen e kapaciteteve përpunuese dhe përdorimit të teknologjisë në tërësi, për të rritur produktivitetin, sigurinë, besueshmërinë dhe efikasitetin e punës.

**Së fundi**, por jo më pak e rëndësishme, KLP-ja i konsideron burimet njerëzore të tij, si një prej asetëve kryesorë që ai ka dhe për këtë arsye, fokusin do ta ketë gjithashtu në drejtim të rekrutimeve të reja, trajnimeve afatshkurtra dhe tematikave të veçanta, trajtimit financiar të tyre brenda mundësive që lejon ligji etj.